



# STUDIM KRAHASUES

POTENCIAL TRANSFORMUES I RINISË NË PROCESET E INTEGRIMIT NË BE  
DHE  
BALLKANI PERËNDIMOR PAS PANDEMISË SË SHKAKTUAR NGA VIRUSI  
COVID-19



Co-funded by  
the European Union



## STUDIM KRAHASUES

### POTENCIAL TRANSFORMUES I RINISË NË PROCESET E INTEGRIMIT NË BE DHE BALLKANI PERËNDIMOR PAS PANDEMISË SË SHKAKTUAR NGA VIRUSI COVID-19

#### AUTORI:

Dragan Sreqković



Ky publikim është i formuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi posaçërisht e Qendrës për kërkime, transparencës, dhe përgjegjësisë - CRTA, dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



# PËRMBAJTJA

|                                                                                              |    |
|----------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Hyrje                                                                                        | 6  |
| Metodologjia e hulumtimit                                                                    | 7  |
| Gjetjet kryesore                                                                             | 8  |
| Rezultatet e hulumtimit                                                                      | 9  |
| Të rinjtë e Ballkanit Perëndimor -<br>politikat publike dhe mekanizmat e pjesëmarrjes        | 9  |
| Të rinjtë e Ballkanit Perëndimor - vlerat themelore                                          | 10 |
| Të rinjtë e Ballkanit Perëndimor dhe BE                                                      | 11 |
| Mekanizmat e pjesëmarrjes së të rinjve në Ballkanin Perëndimor                               | 11 |
| Një pamje e thelluar për pjesëmarrjen e të rinjve të<br>Ballkanit Perëndimor në vendimmarrje | 19 |
| Kuptimi i pjesëmarrjes së të rinjve                                                          | 19 |
| Motivimi - çfarë e inkurajon pjesëmarrjen e të rinjve?                                       | 21 |

|                                                             |    |
|-------------------------------------------------------------|----|
| Pjesëmarrja e të rinjve – mjetet, format, dhe institucionet | 23 |
| COVID-19 kriza dhe pjesëmarrja e të rinjve                  | 26 |
| Të rinjtë e Ballkanit Perëndimor dhe BE -                   |    |
| Vlerat e përbashkëta dhe më pak të përbashkëta              | 28 |
| Përfundime dhe referenca                                    | 29 |
| ANEKS I - Pyetësori për vlerësimin                          | 32 |
| ANEKS II - Udhëzues për intervistë                          | 33 |
| ANEKS III - Referenca                                       | 36 |



## HYRJE

*Do të doja që të rinjtë në Ballkanin Perëndimor të jenë më të lidhur, të shkëmbejnë më shumë përvoja dhe njohuri. Kjo është shumë e rëndësishme sepse të rinjtë në Ballkanin Perëndimor, për fat të keq, nuk dinë mjaftueshëm për njëri-tjetrin. Vitet tragjike të nëntëdhjetës na kanë ndarë. Kemi plotë brenga të përbashkëta dhe probleme të cilat mund ti zgjidhim së bashku ose të paktën të ndihmojmë në realizimin e ndryshimeve pozitive.*

*I anketuari nga Serbia*

Kaq shumë po ndodh në Ballkanin Perëndimor dhe ne do të donim që shumë gjëra të mos kishin ndodhur kurrë. Historia, bukuria, përleshjet, (e kundërvëna) identitetet, rrëfimet e përhershme, problemet e pazgjidhura dhe traumat e thella pulsuese - të gjitha të përqendruara në një rajon. Historia është tani, ajo po ndodh para syve tanë, ne e përjetojmë dhe e formojmë duke folur. Po përpiqemi të kuptojmë të tashmen tonë, por po jetojmë në të kaluarën. Shikojmë pandërprer pas, nuk mund të lirohemi nga bishtat, duke i tërhequr dhe bllokuar dyert e të kaluarës të cilën duam ta mbyllim. Nuk mundemi ta nisim nga fillimi, ta mbyllim atë derë dhe të vazhdojmë përpara. Ku përpara? Duket se rruga jonë e përbashkët është e caktuar - po shkojmë drejt Evropës, edhe pse jemi në Evropë. Gara në mes dy Evropave në mendimin tonë është edhe një paradoks. Në një rast kam fluturuar prej Beogradit (Serbisë) për Brisel (Belgji) përmes Cyrihut (Zvicra). *Pse po vini në Evropë?* Më pyeti doganieri në aeroportin në Cyrih. *Asnjëherë nuk e kam lënë?! Thash, pak i hutuar.* Njëri nga të shqyrtuerit e ka vërejtur në rrjedhim duke krahasuar nivelin e efortit të cilin një i ri mesatar duhet ta investoj për ta mbritur dhe gjën më të vogël me nivelin e efortit të një të riu mesatat prej BE'së: *Egziston ajo fjalë „struggling“ e cila i pasqyron të gjitha ndjenjat e rinisë shqiptare; rinisë e cila është e kufizuar me faktin se është në Evropë, por jashtë saj.*

Gjashtë shoqata të Ballkanit Perëndimor (BP6) - Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovinë, Kosova\*, Mali i zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia janë në rrugën drejt Bashkimit Evropian. Demokracizimi i Ballkanit Perëndimor është në të njëjtën kohë edhe rrugë edhe qëllim. Ishte proces i gjatë por do të zgjatë akoma dhe më gjatë. Në fund, kur të tregohen rezultatet e luftës për demokraci, rajoni jonë do të jetë më ndryshe se tani. Atë do ta udhëheqin njerëzit e tjerë, ndoshta më të mirë se ne - rinia e sotme. Nëse pajtoheni me mua në fjalinë e fundit, tani pse nuk tentoni të hiqni dorë vetëm nga pjesa e asaj fuqie, që rinia e sotme të mundet sa më shpejtë të nis me sundimin!

Ky studim krahasues po përpiqet të identifikojë potencialet transformuese të të rinjve prej trojeve të BP6 në proceset e integrimit në BE dhe ku shtrohen (qëndrojnë) këto potenciale, veçanërisht në dritën e krizës së COVID-it-19. Më saktë, studimi do të hulumtoj dhe të analizoj drejtuesit kryesor dhe motivimet për pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e marrjes së vendimeve, si dhe marrëdhënien në mes motivimit dhe perspektivave ndaj BE'së dhe vlerat e saj themelore. Po ashtu studimi tenton që të tregoj atë çka bën që të rinjtë t'u përmbahen këtyre vlerave në vitin 2020, duke e marrë parasysh dinamikën politike dhe sociale në rajon, si dhe atë që i motivon të nisin përpara dhe të bëhen aktiv në shoqërinë e tyre dhe të ardhmen e rajonit. Studimi veçanërisht hulumton se si kriza COVID-19 ndikon mbi motivimin dhe perceptimin e tyre, si dhe atë se si të rinjtë i perceptojnë efektet e pandemisë mbi pjesëmarrjen e tyre të ardhshme në krijimin e politikave dhe proceseve të integrimit në BE. Analizon cilat janë mjetet dhe qasjet, kur është fjala për pjesëmarrjen e të rinjve, më efektiv, dhe prej të cilëve pritet të jenë më efikas dhe më frytdhënës në të ardhmen.

Ky hulumtim është i përgatitur në kuadër të projektit të gjërë „Të rinjtë e Ballkanit për Evropën“, të mbështetur nga ana e Bashkimit Evropian, qëllimi i cilit është fuqizimi i OCS-vë, veçanërisht organizatave rinore prej BP dhe Turqisë, për pjesëmarrje më efektive në procesin e krijimit të politikës dhe ndjekjes të integrimit në BE. Kryerja e hulumtimeve ishte detyrë kërkimore dhe është kryer kryesisht gjatë verës së vitit 2020, në jehonë të pandemisë COVID-19 e cila ishte mjaft e theksuar në atë kohë dhe që ka ndikuar mbi shumicën e aspekteve të procesit. Përveç kësaj, punimi hulumtues përkoi me fushatat zgjedhore dhe zgjedhjet të cilat mbaheshin në Serbi, në Kosovë dhe Metohi\*, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi. Prandaj mbështetja e plotë dhe bashkëpunimi me skuadrën e CRTA, veçanërisht me Tamara Branković, Nikolla Paunović dhe Igor Stojilović, ishte jashtëzakonisht e rëndësishme, si dhe ekspertiza dhe dedikimi i ekspertëve rajonalë Lejla Kusturicës, Kreshnik Lokes, Ardit Metaj Dikes, Valentina Atanasovskës dhe Aleksandra Gligoroviçit. Ne i jemi mirënjohës Ana Konstatinoviçit për mundimin e saj të jashtëzakonshëm dhe mbështetjen në analizën e dokumentacionit të mbledhur.

\*

Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me RKSKB 1244/1999 dhe Opinionin e GJND-së mbi shpalljen e pavarësisë së Kosovës

# METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Metodat e mbledhjes së të dhënave dhe analizat që i kemi aplikuar gjatë hulumtimit:

1. *Intervistat me fokus grupe* (FG), metoda cilësore e hulumtimit, e cila ka mundësuar kuptimin e thellë të sjelljeve, qëndrimeve, motiveve dhe praktikave. Ajo gjithashtu ka mundësuar mbledhjen e një sasive të madh informacioni në një periudhë relativisht të shkurtër. Gjithsej janë zbatuara 12 fokus grupe, nga 2 në secilën prej bashkësive të synuara, gjatë Qershorit dhe Korrikut të vitit 2020. Grupin e synuar e përbënin të rinjtë të moshës 18 deri 30 vjeç, me një perceptim kryesisht neutral deri më pozitiv të BE'së dhe me përvojë dhe/ose njohuri të pjesëmarrjes në proceset e vendimmarrjes, politikë-bërjes dhe/ose monitorimit në nivelin lokal ose kombëtar. Kjo përbërje e FG-eve siguroi njohuri dhe një pamje të përgjithshme më të thellë në lidhje me pjesëmarrjen e të rinjve, dmth. ata që janë të njohur me procesin e pjesëmarrjes, cilat janë rezultatet (e dëshiruara dhe të padëshiruara) dhe siç tregoi studimi, sa ngushtë është i lidhur me aktivizmin. Me aplikimin e një qasjeje të ngjashme, përfshirja e vetëm atyre me një perceptim më pozitiv të BE'së ka bërë të mundur kuptimin më të mirë të burimit dhe shkakut të perceptimit të tillë, për derisa në të njëjtën kohë ka siguruar hapësirë që pjesëmarrësit e FG-eve gjatë diskutimeve në kuadër të FG-eve të mendojnë më thellë rreth motivimit të tyre, duke e zvogëluar rrezikun nga polarizimi në debatin pro dhe kundër rrëfimit të BE'së. Kjo nuk do të thotë se debatet e tilla janë të padëshirueshme - prespektivat e amatorve vlerësohen shtrenjtë pasi që zakonisht ofrojnë pamje të përgjithshme objektive dhe mund të shprehin sfidë për mendimet dhe përvojat e grupit e cila i përafqëson pikëpamjet e kundërta - por prej këtyre do të kishte më shumë dëm se dobi, duke pasur parasysh diapazonin dhe qëllimet e hulumtimit.

FG-et ishin të përbërë prej 6 deri më 8 pjesëmarrës (mesatarisht 6.3), që mundësonte kontributin aktiv të secilit pjesëmarrës dhe dinamikën grupore të gjallësishtme. Të gjitha intervistat prej FG-eve ishin të kryera nëpërmjet mënyrës elektronike, nëpërmjet platformës Zoom. Janë të regjistruar (audio dhe video) dhe të transkriptuar (dhe të përkthyer sipas nevojës). Intervistat me FG-et kanë zgjatur përafërsisht 120 minuta, ka qenë më shumë se ç'është pritur. Koha mesatare ka qenë më e gjatë se sa është planifikuar për shkak të problemeve teknike, por më së shumti për shkak të moderatorit kërkues dhe motivacionit të madh të cilin e ka treguar shumica e pjesëmarrësve gjatë diskutimit. Secilin FG e ka ndihmuar moderatorin me përvojë, në gjuhën lokale, duke e shfrytëzuar të njëjtin udhëzues për intervistë. Udhëzuesi përbëhej nga dy nivele pyetjesh: kontekstit ose pyetjeve hyrëse, të cilat mundësonin hapjen e temës, dhe pyetjeve të hapura të thella të cilat mundësonin diskutimin më të gjallë dhe shkëmbimin në grup, si dhe më shumë detaje dhe sqarime.

Pjesëmarrësit FG janë të zgjedhur me ndihmë të pyetësorit shqyrtues online i cili përbëhej nga 17 pyetje gjithsej, përfshirë të dhënat kyçe demografike, perspektivën e vlerës të BE-së, nivelin e përvojës, diturisë për pjesëmarrjen në vendimmarrjet, politikë-bërje dhe proceseve të ndjekjes (kombëtare/lokale) dhe kontakt informatat. Në bazë të përgjigjes, pjesëmarrësit janë zgjedhur sipas procedurës quazi-të rastësishme.

2. Puna me analizën e *dokumentacionit* është implementuar gjatë muajit Korrik-Shtator 2020. Ky hulumtim përbëhej nga identifikimi, mbledhja dhe analiza e mekanizmave ekzistuese institucionale kombëtare dhe lokale për pjesëmarrjen e të rinjve në proceset e vendimmarrjes, zhvillimin e politikave dhe ndjekjes në të gjithë rajonin. Analiza është fokusuar në rregulloren/et zyrtare për mekanizmat pjesëmarrës. Të dhënat janë mbledhur me ekzaminimin e legjislacionit zyrtar, të analizave dhe hulumtimeve të mëparshme të cilat i ka zbatuar OSHC'ja kombëtare dhe lokale për të rinjtë, organizatat ndërkombëtare, organizatat e kulmit, institucionet hulumtuese dhe institucionet tjera që janë të kyçur dhe të interesuar për këtë pyetje. Qëllimi i analizës të dokumentacionit ishte të identifikohet rregullorja kombëtare dhe të kuptohet diapazoni dhe arritja, në të njëjtën kohë duke mos hyrë shumë në analizën e politikës. Gjithashtu, analiza e dokumentacionit është shfrytëzuar për të shprehur pamjen më qartë përmes rishikimit të analizave cilësore në përgjithësi, nivelit të pjesëmarrjes të të rinjve në rajon dhe vlerave kyçe të cilat i ndajnë të rinjtë në BP. Analiza e dokumentacionit për këtë arsye ofron kontekst në të cilin duhet të interpretohet analiza cilësore e diskutimeve për FG, veçanërisht duke e marrë parasysh që pjesëmarrësit janë zgjedhur sipas kriterëve të përcaktuara, që do të thotë se mendimet dhe qëndrimet e tyre duhet konsideruar vetëm për atë segment (dominant për BE, dhe të paktën ndonjë përvojë dhe/ose njohuri për pjesëmarrjen e të rinjve).

Edhe pse ajo është përmendur në kapitullin e mëparshëm, duhet të ofrohet edhe një sqarim i detajuar në lidhje me metodologjinë: përgatitjen, selektimin e pjesëmarrësve në FG, intervistat me FG dhe analizat e zhvilluara gjatë pandemisë së COVID-it 19. Kjo ka ndikuar në procesin e përpunimit të studimit, si teknik ashtu dhe tematikisht. Takimet e para të fokus grupeve janë organizuar në kohën kur sapo ka kaluar vala e parë e COVID-19, kurse i dyti ka qenë gjatë periudhës, me epidemitë lokale nëpër gjithë rajonin dhe me pritjen që vala e ardhshme do të ndodhë në vjeshtë. Kjo situatë ka ndikuar mjaft mbi vlerësimin e të anketuarve mbi reaksionet e vet dhe përgjigjes së autoriteteve lokale dhe kombëtare, si dhe mbi perceptimin e tyre të reagimit të të rinjve për këtë situatë unike. Pjesëmarrësve u ka ardhur rëndë të japin çfarëdo parashikimi për atë se si do të ndikojë përvoja me COVID-19 mbi të ardhmen e pjesëmarrjes të të rinjve, pasi askush në atë kohë nuk e ka ditur saktë se si do të zhvillohej mëtej, dhe sa do të zgjatë. Për më tepër, një analizë e një fenomeni global i cili është në vazhdim, dhe i cili ka ndikim të rëndësishëm mbi kontekstin lokal, ishte edhe më e kërkueshme, por më e rëndësishme - asgjë e ngjashme nuk ekziston në kujtesën personale ose kolektive të brezave të tanishëm, veçanërisht të rinjve.



## GJETJET KYÇE

Gjetjet kyçe duhet të ofrojnë më shumë kuptim në pamjen e kontekstit politik dhe social në të cilin jetojnë të rinjtë e Ballkanit Perëndimor, si dhe shikimet më kryesore të rëndësishme për kuptimin e potencialit dhe kufizimit të pjesëmarrjes e të rinjve në rajon.

1. Nëpër gjithë BP6, ndërmjet të rinjve nuk ekziston perceptimi i përbashkët as për BE as për procesin e bashkangjites në BE. Dallimet në perceptim variojnë nga ato më pozitive në Shqipëri dhe Kosovë dhe Metohisë në ato më negative në Serbi.
2. Migrimi i fortë është një nga tiparet më të spikatura të përbashkëta për të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe një numër i madh i të rinjve po mendojnë për largimin drejt në vendeve të tjera jashtë rajonit, para së gjithash për arsye të kushteve jo të kënaqshme.
3. Kuadri rregullator për rininë (pjesëmarrja e të rinjve) nuk është zhvilluar plotësisht në të gjitha shoqëritë e Ballkanit Perëndimor. Megjithatë, ku shumica e ligjeve dhe rregulloreve ekzistojnë, ka qartazi një mungesë të mjedisit të favorshëm, qoftë për shkak të zbatimit të papërshtatshëm ose të pamjaftueshëm, qoftë sepse kuadri ligjor nuk inkurajon pjesëmarrjen e të rinjve.
4. Kuptimi i përgjithshëm i pjesëmarrjeve midis aktivistëve të rinj të intervistuar përfshin një sërë perceptimeve të ndryshme: perceptojnë pjesëmarrjen si një veprimtari formale dhe jozyrtare të kryer nëpërmjet kanaleve formale apo jozyrtare. Pjesëmarrja është gjithashtu e lidhur ngushtë me vetë aktivizmin, i cili këtu përcaktohet si duke mbajtur një qëndrim publik dhe duke u angazhuar në veprimtari që zgjidhin një çështje me rëndësi për publikun.
5. Niveli i besimit në institucionet publike është ndjeshëm i ulët, ndërsa ata gjykojnë se nuk i shërbejnë qëllimit të tyre, apo më keq, se janë të korruptuar. Ky mosbesim shkon dorë për dorë me besimin përgjithësisht të ulët në elitën politike, megjithëse pak më pak në Kosovë dhe Metohinë\* krahasuar me pjesën tjetër të rajonit.
6. Niveli i ulët i besimit në institucionet dhe elitën i bën mjetet jozyrtare dhe mekanizmat për pjesëmarrje më tërheqëse. Këto mekanizma dhe mjete kanë potencial më të fortë demokratik, mbajnë më shumë energji dhe mundësojnë më shumë kreativitet, por ndonjëherë ato janë më pak efektiv dhe më pak të besueshëm në sistemet formale në të cilat merren vendimet.
7. Komunikimi online dhe pjesëmarrja elektronike, nga njëra anë, konsiderohen mjete të shpejta dhe gjithëpërfshirëse, por nga ana tjetër ka një ndërgjegjësim të gjerë për aspektet e tyre negative midis pjesëmarrësve të FG-eve.
8. Kriza e shkaktuar nga pandemia COVID-19, si çdo krizë tjetër e mundshme, përjetohet si një mundësi dhe si një kërcënim. Me fjalë të tjera, në kontekstin e Ballkanit Perëndimor, një pandemi perceptohet si diçka që mund të nxjerrë më të mirën nga të rinjtë: solidaritetin, motivimin dhe kreativitetin dhe më të keqen nga regjimet autokratike, populliste.
9. Shumica e të anketuarve shprehën njohjen e vlerave bazë demokratike lidhur me procesin e integritetit në BE, duke përfshirë të drejtat njerëzore dhe të pakicave, barazinë gjinore, barazinë, tolerancën, gjithë-përfshirjen dhe mendimin kritik (të mbritur përmes arsimit).



## REZULTATET E HULUMTIMIT

### RINIA E BALLKANIT PERËNDIMOR - POLITIKAT PUBLIKE DHE MEKANIZMAT E PJESËMARRJES

Gjashtë shoqëritë e Ballkanit Perëndimor që aspirojnë të bëhen shtete anëtare të BE'së janë në faza të ndryshme përsa i përket zbatimit të normave dhe vlerave të BE'së dhe vërtetimit se ato janë në rrugën e drejtë për t'u bashkuar me BE'në. Përveç një të kaluarë të përbashkët, të komplikuar, këto shoqëri ndajnë faza të ngjashme të zhvillimit kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen e të rinjve, si dhe zhvillimin e politikave rinore në përgjithësi (megjithëse ka disa ndryshime të dukshme që do të paraqiten në kapitujt vijues). Në kërkimin e saj për anëtarësim në BE, i gjithë rajoni po shikon zgjidhje të ndryshme politike dhe institucionale të BE'së me sukses të ndryshueshëm. E njëjta vlen për politikën rinore - ata kanë sukses të ndryshëm në mundësimin dhe promovimin e pjesëmarrjes e të rinjve në mënyra të ndryshme. BE'ja ka miratuar një strategji të re të BE'së për rininë ([https://ec.europa.eu/youth/policy/youth-strategy\\_en](https://ec.europa.eu/youth/policy/youth-strategy_en)), ka themeluar Parlamentin Evropian të Rinisë dhe ka disa organe të ndryshme që mbikqyrin dhe vlerësojnë zbatimin e politikave rinore në nivel evropian. Më së fundi, BE'ja ka një mekanizëm të fuqishëm për mbështetjen financiare, si brenda BE'së ashtu edhe jashtë tij, i cili përqendrohet në rininë dhe është një nga aspektet më të rëndësishme të qëndrueshmërisë së organizatave rinore.

Pranë kësaj, ekzistojnë disa ngjashmëri të tjera midis BP6, dhe disa prej tyre janë perceptimi i të rinjve rreth situatës aktuale në shoqëritë e tyre. Sipas studimeve të kohëve të fundit<sup>1</sup>, të rinjtë nga BP6 (14-29 vjeç) vlerësojnë punësimin dhe mirëqenien ekonomike si vlerat më të rëndësishme socio-politike (përveç Maqedonisë Veriore, ku të drejtat njerëzore vlerësohen me notë më të lartë se dy të mëparshmet). Kjo nuk është për t'u habitur, duke pasur parasysh që shkallët e papunësisë së të rinjve janë të larta - 54% në Bosnjë dhe Hercegovinë, shkalla më e lartë e papunësisë së të rinjve në Evropë në vitin 2016. pastaj në Kosovë dhe Metohi\* dhe në Maqedoninë e Veriut<sup>2</sup>. Në lidhje me këtë, të rinjtë besojnë se detyrat më të rëndësishme të autoriteteve kombëtare janë përqendruar në uljen e papunësisë dhe rritjen ekonomike dhe zhvillimin<sup>3</sup>. Një shqetësim tjetër i përbashkët midis të rinjve është frika dhe pasiguria kur bëhet fjalë për mundësitë e punësimit dhe nëse ata do të jenë në gjendje të gjejnë një punë pas mbarimit të fakultetit. Edhe nëse ata i zhvillojnë aftësitë e tyre sa më mirë që të mundën, kjo në vetvete nuk garanton një punë<sup>4</sup>.

Niveli i angazhimit politik dhe civil të të rinjve nuk duket të jetë i kënaqshëm për arritjen e parimeve të dëshiruara demokratike. Përveç votimit, shumica e të rinjve nuk marrin pjesë në ndonjë formë tjetër të pjesëmarrjes. Përafërsisht 69% e të rinjve në Kosovë dhe Metohi\* dhe në Shqipëri dhe 63% në Malin e Zi asnjëherë nuk kanë bërë vullnetarizëm<sup>5</sup>, dhe pa dëshirë marrin një funksion politik ose marrin pjesë në parti politike<sup>6</sup>.

Një nga aspiratat e zakonshme të të rinjve në të gjithë ZB6 është përqindja e lartë e atyre që duan të emigrojnë. Gati gjysma e të rinjve të Shqipërisë duan të shkojnë në shtet tjetër, ndërsa numri më i vogël është në Malin e Zi, me një të katërtën e popullsisë së re që është me pretendime të largohet<sup>7</sup>. Për pyetjen e arsyeve të emigrimit, shumica e të anketuarve e ka nënshtruar arsyen e njëjtë: ekonomia e keqe<sup>8</sup>.

1 Mirna Jusić, Miran Lavrić and Smiljka Tomanović. (2019). Youth study Southeast Europe 2018/2019. p.46. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung

2 Ibid. p. 25

3 Ibid. p. 46

4 Radoman, Marija. (2019). Vlerat e nxënësve të shkollave të mesme në Serbi-hulumtim 2019 Beograd: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi. Hessyn volumet nr. 38.

5 Mirna Jusić, Miran Lavrić and Smiljka Tomanović. (2019). Youth study Southeast Europe 2018/2019. p.68. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung.

6 Ibid. p. 70

7 Ibid. p. 74

8 Ibid. p. 76

# RINIA E BALLKANIT PERËNDIMOR - VLERAT THEMELORE

Janë tre çështje kryesore të identifikuara nga të rinjtë në Ballkanin Perëndimor si alarmante: papunësia, shpresat e papërmbushura dhe migracioni. Sipas një hulumtimi të kryer në Serbi, më tepër se 50% e të rinjve jetojnë me prindërit e tyre dhe 38% nuk ka asnjë të ardhur<sup>9</sup>. Hulumtime të ndryshme tregojnë se "ekziston një lidhje midis kushteve socio-ekonomike dhe vlerave të të rinjve"<sup>10</sup>. Për shembull, në Shqipëri 87% e të rinjve beson se jeta personale në përgjithësi ose karriera profesionale do të zhvillohet mëtej dhe të përparoj. Por sa i përket të ardhmes së shoqërisë shqiptare në tërësi, 55% e të rinjve besojnë se situata do të përmirësohet, ndërsa 23% besojnë se nuk do të ndryshojë, dhe 15% besojnë se situata ka vetëm për t'u përkeqësuar<sup>11</sup>. Si rezultat i kësaj, të rinjtë e perceptojnë migracionin si mënyra e vetme për të ndryshuar kushtet e tyre të jetesës në më mirë. 60% e të rinjve Shqiptarë shprehin dëshirë të fortë ose të moderuar për të lënë vendin e tyre dhe për të lëvizur jashtë vendit<sup>12</sup>. Arsyeja kryesore është situata e përgjithshme ekonomike. Kërkimi për arsim më të mirë është gjithashtu një nga arsytet për migrimin. Për shembull, prej 92% e të rinjve nga Kosova dhe Metohia\* të cilët synojnë të marrin një diplomë të Fakultetit, 60% e tyre më së miri do të donin ta merrnin diku tjetër, e jo në Kosovë dhe Metohi\*<sup>13</sup>.

Kushtet e këqija të jetesës kombinuar me zhgënjimin në të ardhmen dhe sistemin arsimor dhe mbi të gjitha, një ndjenjë e vetë-përfaqësimit të dobët në institucionet dhe politikën në përgjithësi (64% e të rinjve të Kosovës, për shembull<sup>14</sup>) tregojnë për një situatë shumë dëshpëruese në të cilën gjendet rinia e Ballkanit Perëndimor.

Ekonomia ndikon drejtpërdrejt në orientimin politik të të rinjve që duan të kenë një shtet të fortë që do të siguronte barazinë midis njerëzve. Të rinjtë nga ZB6 mbështesin fuqimisht shtetin e mirëqenies, por nuk i kundërshtohen tregut të lirë dhe tregojnë vlera të larta konsumuese, dhe ky "dualizëm" është karakteristikë e "socializmit mijëvjeçar"<sup>15</sup>. Sipas një studimi të kryer në Kosovë dhe Metohi\*, një e katërta e popullsisë së të rinjve në Kosovë dhe Metohi\* nuk dinin se si të pozicionoheshin në shkallën e majtë/të djathtë të orientimit politik, ndërsa shumica e tyre (36%) anojnë nga qendra. Sa i përket Serbëve të Kosovës dhe Metohisë\*, pothuajse një e treta nuk dinin si ta vendosnin veten në shkallë, 65% janë neutralë ose anojnë nga qendra<sup>16</sup>. Situata është e ngjashme në Maqedoninë Veriore, ku gati 50% nuk dinin si të vendoseshin. Nga ata që ishin në gjendje të bënin dallimin midis orientimit politik të majtë dhe të djathtë, 37% zgjedhën krahun e majtë, 35% qendrën dhe 28% krahun e djathtë<sup>17</sup>. Krahastuar me gjetjet e vitit 2013, orientimi drejt krahut të majtë u rrit për 14%, ndërsa preferenca e krahut të djathtë ka rrënë për 11%.<sup>18</sup>

Sa i përket vlerave të përgjithshme të jetës, rinia e Serbisë i vlerëson më së shumti ato që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me familjen, ndërsa respekti i vlerave në lidhje me angazhimin qytetar dhe politik më i vogël<sup>19</sup>. Ngjashëm me Serbinë rinia e Shqipërisë ka deklaruar se për to vlerat familjare janë më të rëndësishme, si dhe besnikëria ndaj miqve, partnerëve dhe punëdhënësve dhe më së fundi, karierra e sukseshme<sup>20</sup>. Vlera e orientimit së të rinjve të Malit të Zi tregon se një numër i konsiderueshëm i të rinjve janë të prirur ndaj modeleve autoritare dhe konservatore<sup>21</sup>. Përveç këtyre dallimeve, të rinjtë në Kosovë dhe Metohi\* janë të ndarë kur bëhet fjalë për vlerat: ndërsa të rinjtë Shqiptarë nga Kosova dhe Metohia\* thonë se i konsiderojnë altruizmin, tolerancën dhe drejtësinë si vlerat më të rëndësishme, të rinjtë Serbë në Kosovë dhe Metohi\* besojnë se dinjiteti personal dhe njohja shoqërore janë vlerat më të rëndësishme.<sup>22</sup>

Është një zbulim interesant se pavarësisht një mosbesimi të madh ndaj institucioneve politike dhe mungesës së besimit se me angazhimin e tyre në politikë ato mund të ndryshojnë çdo gjë, ka ende një përqindje të lartë të të rinjve që votojnë në zgjedhje. Për shembull, në Kosovë dhe Metohi\*, 82% e të rinjve votuan në zgjedhjet e fundit

9 Radoman, Marija. (2019). Orientimet e vlerës së nxënësve të shkollave të mesme në Serbi-hulumtim 2019 Beograd: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi. P. 18-20. Helsinkit volumet numër 38.

10 Ibid. p. 18

11 Kamberi, Geron & Çela, Alba. (2019). Youth Study Albania 2018/2019. p. 16. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung.

12 Ibid. p. 35

13 Rrumbullaku, Olton. (2019). Youth study in Kosovo\* 2018/2019. p. 7. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung.

14 Rrumbullaku, Olton. (2019). Youth study in Kosovo\* 2018/2019. p. 49. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung

15 Ibid. p. 48

16 IDRA Team of authors. (2012). Kosovo\* youth study. Forward looking grounded in tradition. p. 48. Friedrich Ebert Stiftung

17 Topuzovska Latković, Marija et al. (2019). Youth Study North Macedonia 2018/2019. p. 71. Friedrich Ebert Stiftung.

18 Ibid., p. 71

19 Popadiq, Dragan; Pavloviq, Zoran & Mihailović Srećko. (2018). Të rinjtë në Serbi 2018/2019. p. 26 Friedrich Ebert Stiftung

20 Kamberi, Geron & Çela, Alba. (2019). Youth Study Albania 2018/2019. p. 15. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung

21 Westminster Foundation for democracy. (2019). Youth perception and attitudes towards politics in Montenegro. p. 48

22 Ibid. p. 21

## RINIA E BALLKANIT PERËNDIMOR DHE BE

Të rinjtë në Ballkanin Perëndimor përgjithësisht kanë qëndrime pozitive për bashkëngjitjen në anëtarësimin e plotë ligjshëm në BE, me përjashtim të Serbisë. Niveli i mbështetjes ndryshon, por arsyeja kryesore është e njëjtë në të gjithë BE'në: përmirësimi i standardeve të jetesës.

Sipas një Sondazhi nga Barometri i Ballkanit, 59% e pjesëmarrësve nga ZB6 u përgjigjën se bashkëngjitja me BE'në do të kishte një ndikim pozitiv mbi ekonominë e shoqërive të tyre. Megjithatë, dallimet në mes të përgjigjeve në të gjithë BP6 janë të rëndësishme. Besimi më i madh se bashkëngjitja me BE'në do të kishte një efekt pozitiv mbi ekonominë është shprehur nga të pyeturit në Shqipëri me 87% dhe në Kosovë dhe Metohi me 75% me një qëndrim për t'u bashkëngjitur me BE'në (55% në Malin e Zi). Në Serbi, besimi se ekonomia do të përmirësohet është më i ulët - 26%. Veç kësaj, 24% besojnë se kjo do të kishte në fakt një ndikim negativ në ekonominë e Serbisë<sup>23</sup>. Të dhënat e fundit tregojnë se 46% e të rinjve në Serbi nuk mbështesin anëtarësimin në BE dhe vetëm 33% janë në favor të anëtarësimit të Serbisë<sup>24</sup>. Kur u pyetën se çfarë do të thotë BE për ta personalisht, të anketuarit përmendën në radhë të parë prosperitetin ekonomik, lirinë për të studiuar dhe/ose punuar në BE dhe, së fundi, lirinë për të udhëtuar<sup>25</sup>.

Mbështetjen më të madhe BE'në e shprehin Shqiptarët dhe Shqiptarët e Kosovës\* (88%)<sup>26</sup>. Megjithatë, Serbët të Kosovës dhe Metohisë\* duket se janë më skeptikët kur është pyetja për BE'në, duke qenë se 56% e tyre e kundërshtojnë atë<sup>27</sup>. Një nga të anketuarit, duke iu përgjigjur pyetjes pse nuk e mbështet BE'në, deklaroi: "Njerëzit janë kundër integritetit në BE pasi që BE'ja e ka përkrahur bombardimin e këtij vendi. Ato nuk mund të jenë miqtë tanë. Integriteti në BE nënkupton heqjen e dinjitetit tonë kombëtar"<sup>28</sup>. Statistikat tregojnë gjithashtu se 69% e të rinjve në Maqedoninë veriore do të votonin për t'u bashkëngjitur me BE'në. Megjithatë, kjo nuk është aq e lidhur me vlerat e proklamuar të BE'së, por më shumë me arsye pragmatike, sepse kjo do të sillte përfitim material dhe përmirësim të përgjithshëm të situatës së tyre ekonomike<sup>29</sup>.

## MEKANIZMAT E PJESËMARRJES SË TË RINJVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Ky kapitull merret me mekanizmat institucionalë që duhet të mundësojnë dhe inkurajojnë pjesëmarrjen e të rinjve, si dhe qasjet të tjera përmes të cilave të rinjtë mund të përfshihen në proceset e vendimarrjes. Për qëllime analitike, pjesëmarrja e të rinjve grupohet në tre kategori kryesore:

1. Pjesëmarrja në institucionet shtetërore
2. Pjesëmarrja përmes OSHC'së
3. Vullnetarizmi

Për shkak të ngjashmërive të përgjithshme politike dhe institucionale midis shoqërive të BP6, qasjet në pjesëmarrje të të rinjve, modaliteteve të tyre dhe mundësive në kornizat e duhura të politikë-bërjes janë të ngjashme. Megjithatë, ka disa ndryshime në mënyrën e zhvillimit të politikave publike në pamjen e pjesëmarrjes së të rinjve dhe asaj të cilat mekanizma janë të njohur. Ky kapitull do të paraqesë një analizë konkrete të secilës shoqëri në Ballkanin Perëndimor.

23 Regional Cooperation Council. (2020). Balkan Barometer. Public opinion-analytical report.(p. 37-41). Sarajevo: Regional Cooperation Council  
24 Stojanović Boban, Ivković, Aleksandar. (2020). Raport alternativ mbi pozitën dhe nevojat e rinisë në Republikën e Serbisë - 2020. Vite. P. 156.  
Organizata e kulmit e rinisë Serbe-KOMS.  
25 Ibid., p. 41  
26 Rrumbullaku, Olton. (2019). Youth study in Kosovo\* 2018/2019. p. 54. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung  
27 Ibid. p. 56  
28 Rrumbullaku, Olton. (2019). Youth study in Kosovo 2018/2019. p. 54. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung  
29 Vangeli, Anastas. (2019). Public Opinion and Popular Narratives Ahead of the EU Council in Fall 2019. China CEE institute.

## SHQIPËRIA

Shqipëria është vendi i dytë më i ri në Evropë për nga struktura e moshës, me pothuajse 25% të të rinjve në popullsinë totale. Megjithatë 62% të rinjve shqiptarë nuk i intereson politika, ekzistojnë mekanizma për pjesëmarrjen e të rinjve, por sipas të gjitha gjasave të pamjaftueshëm.

Rinia shqiptare nuk është e interesuar të marrë pjesë në politikë nëpërmjet partive politike- një hulumtim relevant tregon se 87% e tyre nuk kanë qenë kurrë të lidhur me një parti politike<sup>30</sup>. Veç kësaj, 58% e tyre nuk ka besim në partitë politike. Edhe më problematike është se më shumë se gjysma e të rinjve të Shqipërisë nuk u besojnë institucioneve të tilla siç janë presidenti, parlamenti dhe qeveria<sup>31</sup>, gjë që shpjegon nivelin e ulët të pjesëmarrjes.

Shqipëria nuk ka miratuar ende një ligj mbi rininë dhe nuk ka përcaktuar një kufi moshe për moshën e rritur; megjithatë, zakonisht i referohet njerëzve prej moshës 15 deri në 29 vjeç<sup>32</sup>. Strategjia për Rininë të cilën e ka miratuar qeveria Shqiptare, Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020, "është i vetmi akt ligjor që rregullon zbatimin e veprimtarive rinore në nivel lokal dhe kombëtar"<sup>33</sup>. Krijimi dhe miratimi i kësaj strategjie do të thoshte dhe pjesëmarrje vetveti, pasi 12,000 të rinj morën pjesë në fazën e konsultimeve<sup>34</sup>. Gjithashtu duket të ketë fokusin e vërtetë - qëllimi i saj i parë është *promovimi i të rinjve dhe pjesëmarrja në proceset demokratike/vendimmarrjeve*, dhe i dyti *promovimi i nënpunësimit të të rinjve përmes politikës efektive të tregut të punës*<sup>35</sup>. Plani i veprimit me siguri e njeh pjesëmarrjen si një domosdoshmëri dhe vlerë dhe papunësinë si një nga pyetjet kyçe me të cilat ballafaqohet rinia shqiptare.

Me qëllim që të zhvillohet një rrjet më i mirë i OSHC'së ekzistuese dhe të përmirësohet niveli i bashkëpunimit me autoritetet publike, në vitin 2015. është themeluar Këshilli kombëtar për Shoqërinë civile<sup>36</sup>, i cili ndikon edhe mbi punën e organizatave rinore.

Organizatave rinore zakonisht u mungon personeli me kohë të plotë dhe luftojnë për të arritur qëndrueshmërinë financiare. Varësia e tyre nga donatorët ndërkombëtarë nuk kontribuon në qëndrueshmërinë e tyre dhe zvogëlon mundësinë e të rinjve për t'u angazhuar dhe marrë pjesë në aktivitetet e tyre<sup>37</sup>, ndërsa mbështetja për organizatat rinore që vijnë nga institucionet/organizmat shtetërore është e kufizuar. Ndonse janë 174 organizata dhe grupe jozyrtare në Shqipëri, ato për shkak të konkurrencës së vet më shumë të lidhur më organizatat e tjera në rajon, se sa në nivelin kombëtar<sup>38</sup>. Gjithashtu, të dhënat tregojnë se më shumë se 40% e të rinjve shqiptarë nuk i besojnë OSHC'së<sup>39</sup>.

Përveç kësaj, vullnetarizmi nuk duket të jetë tepër i famshëm midis rinisë shqiptare. Përpara se të fillonte transformimi kah demokracia liberale, shtetasit kanë qenë të detyruar për punë të rëndë vullnetare (që në fakt ishte punë e detyruar), kështu që perceptimi negativ i vullnetarit mbeti<sup>40</sup>. Ligji për vullnetarizëm u miratua në vitin 2016. me qëllim të "të inkurajojë angazhimin qytetar dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në zhvillimin e komunitetit"<sup>41</sup>.



30 Ibid., p. 69

31 Ibid., p. 68

32 Loka, Kreshnik. (2017). Contribution of non-programme countries to EU youth Wiki. Chapter I: Albania youth policy governance. p. 2. Council of Europe.

33 Ibid. p. 3

34 Ibid. p. 3

35 Ibid.

36 Ibid. p. 6.

37 Albania in the Berlin process. (2016). A Mapping and Comparative Assessment of Youth Organizations in the Western Balkans. An Insight to Youth Organizations and Youth Policy in Albania, Montenegro and Serbia. p. 7.

38 Ibid. p. 8

39 Kamberi, Geron, Çela, Alba. (2019). Youth Study Albania 2018/2019. p. 68. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung.

40 Topalli, Irena. (2018). Contribution of non-programme countries to EU youth Wiki. Chapter II: Voluntary activities. p. 3. Council of Europe.

41 Ibid. p. 4

## BOSNJË DHE HERCEGOVINË

Apatia midis të rinjve në Bosnje dhe Hercegovinë është e dukshme, e ngjashme me atë në të gjithë rajonin. Të rinjtë konsiderojnë (77% e tyre) që kanë pak ose aspak ndikim në vendim-marrjen në nivelin lokal<sup>42</sup>. Të rinjtë që vijnë nga grupe të ndjeshme janë edhe më të bindur se nuk kanë ndikim në vendim-marrjet<sup>43</sup>. Të rinjtë nuk u besojnë partive politike dhe politikanëve, veç kësaj ata besojnë se njerëzit që u bashkangjiten partive politike e bëjnë këtë për interesin e tyre<sup>44</sup>.

Ndonse nuk ka ligj për rininë në nivelin shtetëror, ka 3 ligje të ndryshme për rininë: çdo entitet ka një - Ligji për të Rinjtë në Federatën e Bosnjë dhe Hercegovinës dhe Ligji për Organizatat Rinore në Republikën Srpska, plus Ligji për Rininë në Rrethin Brčko<sup>45</sup>. Të tre ligjet i përcaktojnë të rinjtë si njerëz që i përkasin grupmoshës nga 15 deri në 30 vjeç. Këto ligje lejojnë të rinjtë të marrin pjesë përmes grupeve joformale, shoqatave dhe organizatave kulmuese. Në të vërtetë ekzistojnë tre organizata e kulmit rinor: Këshilli Rinor i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës, Këshilli Rinor i Republika Srpska dhe Këshilli Rinor i Rrethit Brčko<sup>46</sup>.

Megjithëse ka politika rinore, nuk ka asnjë Strategji të Rinisë në nivelin kombëtar dhe vetëm Republika Srpska ka zhvilluar strategjinë për të rinjtë<sup>47</sup>. Strategjia e tanishme 2016-2020. thekson punësimin dhe pjesëmarrjen aktive si përparësitë kryesore<sup>48</sup>. Sidoqoftë, 72% e të rinjve nuk u besojnë institucioneve, gjë që është në përputhje me apatinë e dukshme dhe nivelin e ulët të pjesëmarrjes<sup>49</sup>. Historikisht, vullnetarizmi në Bosnjë dhe Hercegovinë ka rrënjë të forta dhe ka qenë mjaft i shpeshtë. Sipas një studimi të kryer në vitin 2017. 14% e të rinjve aplikuan në vitin e kaluar<sup>50</sup>. Sidoqoftë, nuk ka asnjë kornizë rregullatore në nivelin kombëtar, ndërsa si Republika Srpska ashtu edhe Federata e Bosnjë dhe Hercegovinës kanë ligjet e tyre mbi vullnetarizmin<sup>51</sup>.

Autorët e cekur: Dushanicaq Srgjan, Lakiq Sinisha dhe Turjaçanin Vladimir kanë gjetur korelacion të fortë mes pjesëmarrjes dhe besimit në institucionet dhe rekomandojnë ndryshimin e strategjisë së komunikimit me të rinjtë nga ana e qeverisë së BiH që të rinjtë të ndjehen të nevojshëm sistemit politik dhe shoqërisë në tërësi. Poashtu, ata theksojnë se formimi i besimit në institucionet duhet të nis nga sistemi arsimor pasi që pikërisht përmes arsimit për herë të parë hasen me institucionet.



42 United Nations. (2016). Voices of Youth. Research into youth in BiH. Dijalog za budućnost. p. 67

43 Ibid. 67

44 Ibid. 67

45 Këshilli i të rinjve të Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës. Fakat është vakët për të rinjtë- Një udhëzues për ligjet dhe të drejtat e rinisë në Bosnje dhe Hercegovinë. p. 1

46 Ibid. p. 5

47 Jashareviq, Jasmin. (2017). Contribution of non-programme countries to EU Youth Wiki. Chapter I. Bosnia and Herzegovina: Youth Policy Governance. p. 4.

48 Ibid. p. 4

49 Dushanicaq, Srgjan. Lakiq, Sinisha. & Turjaçanin, Vladimir. (2017). Pjesëmarrja qytetare dhe politike e rinisë- qasje psikologjike. p. 94. Friedrich Ebert Stiftung. Banja Luka.

50 Jašareviq, Jasmin & Jevdiq, Jugoslav. (2018). Contribution of non-programme countries to EU Youth Wiki. Bosnia and Herzegovina Chapter II: Voluntary Activities. p. 3. Council of Europe.

51 Ibid., p. 4



## KOSOVA DHE METOHIA\*

Popullsia e Kosovës dhe Metohisë\* është më re në Evropë, me 55% të popullatës më e re se 30. vjet<sup>52</sup>. Kjo paraqet shtypje të madhe mbi qeverinë e Kosovës dhe Metohisë të investoj në ndërtimin dhe implementimin e politikave dhe mekanizmave të pjesëmarrjes në lidhje me të rinjtë. Një vit pas shpalljes së pavarësisë, qeveria e Kosovës dhe Metohisë\* ka miratuar *Ligjin për fuqizimin e pjesëmarrjes të të rinjve*<sup>53</sup>. Dallimi nga çdo ligj tjetër për të rinjtë në rajonin e BP6 është se ligji në Kosovë dhe Metohi\* përcakton të rinjtë midis moshës 15 dhe 24 vjeç<sup>54</sup>, duke e kapërcyer popullsinë e të rinjve nga 24 deri në 29 vjeç. Institucionet më të rëndësishme të përcaktuara nga ky ligj janë Këshilli Qendror i Veprimit për Rininë, Këshilli Lokal i Veprimit për Rininë dhe Qendrat Rinore<sup>55</sup>.

Përveç ligjit, Kosova dhe Metohia\* ka miratuar Strategjinë e Rinisë 2019-2023, e cila si tre qëllimet e para i thekson: 1. *Mobilizimin e të rinjve për të marrë pjesë*, 2. *Sigurimin e aftësive dhe përgatitjen e të rinjve për tregun e punës dhe* 3. *Një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurt*<sup>56</sup>. Strategjia thotë se, për të arritur një pjesëmarrje më të madhe të të rinjve, ajo duhet të përqendrohet në ndërtimin e kapaciteteve të organizatave rinore dhe sigurimin e mbështetjes financiare për iniciativat e aktivistëve të të rinjve<sup>57</sup>. Pranë kësaj, komunat shihen si aktorë të rëndësishëm, e cila duhet të rrit angazhimin e të rinjve. Edhe pse shumica e komunave kanë bërë progres në zhvillimin e politikave të rinisë lokale, jo të gjitha komunat kanë një buxhet të mjaftueshëm për t'i zbatuar ato<sup>58</sup>. Megjithatë këto organe janë të parashikuara me ligj, sipas anketës, 25% e studentëve nuk kishin dëgjuar kurrë për Planin e Veprimit, dhe vetëm 23% e dinin se ekzistonte një Ligj për Rininë<sup>59</sup>. Megjithatë Plani i Veprimit i Rinisë së Kosovës dhe Metohisë\* është në përputhje me standardet evropiane, të rinjtë nuk duket se e kanë njohur atë si një dokument që plotëson nevojat e tyre, por si një dokument të kontrolluar nga donatorët, pasi 28% e buxhetit të saj financohet nga komuniteti kombëtar<sup>60</sup>.

Ndonëse duket se ekziston rregullore e favorshme, të dhënat tregojnë se 90% e të rinjve nga 18 deri 25 vjeç nuk kanë qenë kurrë anëtarë të ndonjë organi politik, OSHC, organizatës rinore apo çfarëdo grupi tjetër rinor<sup>61</sup>. Pas luftës për pavarësi, sektori civil në Kosovë dhe Metohi\* u forcua, falë ndihmës financiare të huaj. Një numër i madh i OSHC-ve, të varura nga fondet e donatorëve ndërkombëtarë, janë zhdukur. Duket se gjithashtu ka një mungesë solidariteti midis organizatave rinore, pasi ato konkurrojnë për financim<sup>62</sup>. Sipas disa të dhënave të mbledhura më parë, ka rreth 90 organizata aktive rinore në Kosovë me shumë pak anëtarë<sup>63</sup>. Gjithashtu, aktivizmi qytetar nuk duket të jetë i popullarizuar në mesin e të rinjve të Kosovës, me vetëm 13% të atyre që kanë bërë vullnetarizëm në kornizat e aktiviteteve të shoqërisë civile. Ekziston gjithashtu një ndryshim midis të rinjve Serbë dhe Shqiptarë në Kosovë dhe Metohi\*, me më shumë aktivistë në anën serbe, respektivisht 30% e tyre të cilët kanë bërë vullnetarizëm<sup>64</sup>.



52 Rrumbullaku, Olton. (2019). Youth study in Kosovo\* 2018/2019. p. 4. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung.  
 53 Assembly of the Republic of Kosovo\*. (2009). Law No. 03/L-145 on empowerment and participation of youth.  
 54 Ibid. p. 1  
 55 Ibid.  
 56 Republic of Kosovo\*. Ministry of Culture, Youth and Sports. (2019). Strategy for youth 2019-2023.  
 57 Ibid. 23-24  
 58 Ibid. p. 9  
 59 Feltes, Tilmann. (2013). Youth and Democracy: The Promotion of Youth Participation by the International Community in Kosovo\*. p. 203. Security and Human Rights 24 (2013) 195-209. Martinus Nijhoff Publishers.  
 60 Ibid. p. 203.  
 61 International Foundation for Electoral Systems. (2016). The role of Youth in political entities in Kosovo\*. p. 3  
 62 Feltes, Tilmann. (2013). Youth and Democracy: The Promotion of Youth Participation by the International Community in Kosovo\*. p. 201. Security and Human Rights 24 (2013) 195-209. Martinus Nijhoff Publishers.  
 63 Ibid. p. 201.  
 64 Rrumbullaku, Olton. (2019). Youth study in Kosovo\* 2018/2019. p. 61. Berlin: Friedrich Ebert Stiftung.

## MALI I ZI

Kërkimet e fundit tregojnë se nivelet e pjesëmarrjes së të rinjve apo edhe interesimet për politikën në Mal të Zi nuk janë të larta. Sipas rezultateve të anketës, 31% e të rinjve nuk e ndjekin kurrë politikën, ndërsa 49% e ndjekin atë me vëmendje të kufizuar: ekziston një përqindje e lartë (80%) e të rinjve që nuk janë veçanërisht të interesuar në politikë<sup>65</sup>. Më shumë se 75% e të rinjve nuk janë anëtarë të ndonjë partie politike. Gjithashtu, më shumë se 70% nuk shohin një ndryshim midis partive politike ose mendojnë se ndryshimet janë të vogla<sup>66</sup>. Gjithashtu, vetëm 24% i të rinjve do të dëshironin që Mali i Zi të ketë një udhëheqës demokratik, ndërsa tipi më i famshëm i udhëheqësit është popullist (34%), pastaj paternalist (21%) dhe tipi autoritar (21%). Mali i Zi ka udhëheqës demokratik, ndërsa tipi më i famshëm i udhëheqësit është popullist (34%), pastaj paternalistik (21%) dhe tipi autoritar (21%)<sup>67</sup>.

Qeveria e Malit të Zi e ka miratuar Ligjin për Rininë relativisht vonë - në 2019. Në grupin e të rinjve hyn popullata e moshës 15-30 vjeç<sup>68</sup>. Sipas anketës IPSOS, 21% (132.702) e të rinjve janë të moshës 15-29 vjeç. Disa nga gjetjet kryesore të atij studimi janë se qytetarët besojnë se autoritetet manipulojnë me të rinjtë dhe se pjesëmarrja e tyre është vetëm deklarative dhe se asgjë e rëndësishme nuk ndryshon<sup>69</sup>. Me ligj përcaktohet Këshilli për Rininë, organi koordinativ i ngarkuar për shërbimet e rinisë, të cilët janë të përbërë nga klube të rinjsh dhe qendra rinore<sup>70</sup>. Ministria e Arsimit dhe Ministria e Sportit kanë zhvilluar Strategjinë Rinore 2017-2021, e cila përqendrohet në gjashtë prioritetet: 1. Siguria Ekonomike dhe Sociale, 2. Cilësia e Arsimit, 3. Pjesëmarrja në Vendim-Marrje, 4. Shëndeti, 5. Kultura dhe 6. Kornizë normative dhe institucionale për zbatimin e politikave rinore<sup>71</sup>.

Ligji mbi vullnetarizmin tregon të njëjtin lloj keqkuptimi të konceptit të vullnetarizmit si në Maqedoninë e Veriut (dhe Serbinë), sepse ai shihet si një punë. Njerëzve nën 15 vjeç iu ndalon madje të bëjnë punë vullnetare, edhe nëse shkolla organizon ngjarje të tilla<sup>72</sup>. Meqënëse nuk ka kulturë të vullnetarizmit apo stimujve aktualë nga shteti, nuk është për t'u habitur që 72% e të rinjve u përgjigjën se nuk ishin vullnetarë apo ishin anëtarë të një shoqatë apo OSHC<sup>73</sup>.

Duket e vështirë të mbërish deri në një numër të saktë organizatash aktive të rinisë në Malin e Zi për shkak të mungesës së të dhënave të përditësuara në regjistrin kombëtar. Gjithashtu, nuk ka asnjë organizatë të kulmit për të rinjtë<sup>74</sup>. Megjithatë, ka një numër të madh organizatash aktive studentore, që duket mënyra më e famshme e angazhimit të të rinjve<sup>75</sup>.



65 Westminster Foundation for Democracy. (2019). Youth perception and attitudes towards politics in Montenegro. p. 7

66 Ibid., p. 13-14

67 Ibid., p. 11

68 LIGJI PËR TË RINJTË. "Gazeta zyrtare e Malit të Zi", nr. 025/19 prej 30.04.2019, 027/19 prej 17.05.2019

69 IPSOS. (2013). KAP hulumtim - hulumtim mbi njohuritë, qëndrimet dhe sjelljen e shtetasve Malazezë në lidhje me punësimin dhe pjesëmarrjen e të rinjve. p. 34-35

70 LIGJI PËR TË RINJTË. "Gazeta zyrtare e Malit të Zi", nr. 025/19 prej 30.04.2019, 027/19 prej 17.05.2019

71 Ministria e Arsimit e Malit të Zi & Ministria e Sporteve e Malit të Zi (2016) Strategjia për të rinjtë 2017-2021. p. 8.

72 [http://www.strategijazamlade.me/download/Ishod%20C%20\(aktivacija%20mladih\).pdf](http://www.strategijazamlade.me/download/Ishod%20C%20(aktivacija%20mladih).pdf) . p. 36

73 Westminster Foundation for Democracy. (2019). Youth perception and attitudes towards politics in Montenegro. p. 20

74 Albania in the Berlin process. (2016). A Mapping and Comparative Assessment of Youth Organizations in the Western Balkans. An Insight to Youth Organizations and Youth Policy in Albania, Montenegro and Serbia. p. 11-12

75 Ibid. 11-12.

## MAQEDONIA E VERIUT

Studimet tregojnë se të rinjtë në Maqedoninë e Veriut nuk janë të interesuar për politikë. Hulumtimi i fundit tregoi se 17% e të rinjve janë të interesuar për politikë, e cila është në mënyrë të konsiderueshme më e ulët se 50% e regjistruar në 2013<sup>76</sup>. Mund të ketë dy shpjegime për këtë: E para është që 80% e të rinjve besojnë se autoritetet nuk kujdesen fare për ta ose vetëm pjesërisht për ta dhe nevojat dhe problemet e tyre. Arsya e dytë është ndjenja e tyre e paaftësisë për të ndikuar në mënyrën se si autoritetet marrin vendime.<sup>77</sup>

Nuk ka ligj kombëtar për rininë në Maqedoninë veriore, megjithatë Agjencia për Rini dhe Sport ka filluar procedime dhe ka hartuar një ligj. Megjithatë, për shkak të pjesëmarrjes së pamjaftueshme të përfaqësuesve të organizatave rinore, teksti është dorëzuar për rishikim<sup>78</sup>. Dokumentet kryesore në lidhje me rininë janë *Strategjia Kombëtare për Rininë 2016-2025* dhe *Plani i Veprimit dhe Monitorimit*<sup>79</sup>. Këto dokumente të politikave përcaktojnë të rinjtë si persona të moshës 15-29 vjeç; përqindja e këtij grupi në popullsinë e përgjithshme të Maqedonisë veriore del 21%<sup>80</sup>. Prioritetet kryesore të përcaktuara në Strategjinë e Rinisë janë: 1. *Sigurimi i një standardi më të mirë ekonomik për të rinjtë*, 2. *Krijimi i kushteve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore*, 3. *Përfshirja e të rinjve në monitorimin dhe zbatimin e politikave përkatëse dhe* 4. *Aksesi i barabartë në arsim*<sup>81</sup>.

Ende nuk ka mekanizma zyrtarë për konsultim me të rinjtë, përveç thirrjeve publike për pjesëmarrje në grupe pune tematike, që do të thotë se p

Pjesëmarrja në procese politikash përveç atyre që lidhen drejtpërdrejt me pyetjet e të rinjve, nuk është e garantuar nga asnjë rregullore, duke rezultuar në pjesëmarrje të ulët të të rinjve. Të dhënat tregojnë gjithashtu se ka një nivel të ulët të angazhimit qytetar të të rinjve, veçanërisht grupeve të marginalizuara. Kjo gjithashtu tregon se të rinjtë Maqedonas, të cilët janë më të arsimuar dhe të punësuar, janë më të angazhuar krahasuar me të rinjtë Shqiptarë, të cilët janë më pak të arsimuar dhe më të papunë<sup>82</sup>.

Ligji i Maqedonisë së Veriut për Vullnetarizmin kontribuon shumë në pjesëmarrjen e të rinjve, sepse e ka definuar vullnetarizmin si një formë të angazhimit pune, i cili sipas shumë vetave është një koncept i keqkuptuar<sup>83</sup>. Raporti i Gallupit (2016) e rendit Maqedoninë e Veriut në dhjetë vendet e renditura më të ulët kur bëhet fjalë për përqindjen e qytetarëve që janë vullnetarë, me vetëm 7% të popullsisë<sup>84</sup>.

Ndonse nuk ka asnjë organizatë e kulmit zyrtare kombëtare për të rinjtë në Maqedoninë Veriore, ka dy organizata me potencial të madh: Këshilli Kombëtar Rinor i Maqedonisë Veriore (NYCM) dhe Koalicioni i Organizatave Rinore (SEGA)<sup>85</sup>. NYCM përmbledh më shumë se 40 organizata rinore dhe mbulon një gamë të gjerë temash, si nga zonat rurale ashtu dhe urbane, si dhe krahët të partive politike rinore<sup>86</sup>. Nga ana tjetër, SEGA përqendrohet kryesisht në lobimin për ndryshimet legjislative dhe përbëhet nga 12 anëtarë dhe 14 organizata të përbashkuar<sup>87</sup>. Ekzistojnë 103 organizata rinore në Maqedoninë veriore, kurse shumica e tyre janë në rajonin e Shkupit<sup>88</sup>. Si gjëkund tjetër në rajon, organizatat rinore përballen me një mungesë fondesh dhe veprojnë në këtë mënyrë nga një projekt dhuruesish në tjetrin. Kjo nuk kontribuon në qëndrueshmërinë e tyre afat-gjatë. Si rrjedhojë e kësaj, nuk ka staf të mjaftueshëm të aftë, dhe nivelet e anëtarësimit janë të ulta. Nga ana pozitive, megjithatë, kohët e fundit është evident rrjetëzimi më i madh midis organizatave rinore<sup>89</sup>.

76 Topuzovska Latković, Marija et al. (2019). Youth Study North Macedonia 2018/2019. p. 68. Friedrich Ebert Stiftung.

77 Galevski, Martin. (2019). Socio-political participation of Youth in North Macedonia: Apathy, Optimism or Disappointment? p. 9. Westminster Foundation for Democracy.

78 European Commission. (2017). Youth Wiki national description. Youth policies in the former Yugoslav Republic of Macedonia. p. 8.

79 Ibid. p. 7.

80 Ibid. p. 7.

81 Agencija za mladi i sport. (2016). National Youth Strategy 2016-2025. p. 11.

82 Ibid. p. 38.

83 Ibid. p. 17.

84 Westminster Foundation for Democracy. (2019). Socio-political participation of Youth in North Macedonia: Apathy, Optimism or Disappointment? p. 27.

85 Ibid. p. 25.

86 Ibid. p. 25.

87 Ibid. p. 25.

88 Ibid. p. 26.

89 Ibid. p. 27.



## SERBIA

Në Serbi ekzistojnë vetëm 18.4% të të rinjve sipas regjistrimit të vitit 2011, numri më i ulët krahasuar me të tjerët në rajon. Më shumë se gjysma e tyre nuk janë aspak të interesuar për politikë<sup>90</sup>. Niveli i besimit në institucionet publike është gjithashtu i ulët - më shumë se 50% nuk i besojnë institucionit të presidentit<sup>91</sup>, ndërsa partitë politike janë më pak të besueshme - 56% i të rinjve nuk u besojnë atyre, ndërsa 38% janë indiferentë<sup>92</sup>.

Rezultati pozitiv i zgjedhjeve të fundit parlamentare është se 28 vetë nën moshën 30 vjeç do të jenë deputetë<sup>93</sup>, e cila është më shumë se 10% e vendit në parlament. Megjithatë, të jesh anëtar i një partie politike nuk është aq e popullarizuar në mesin e të rinjve, pasi më shumë se 86% nuk janë anëtar i ndonjë partie politike<sup>94</sup>.

Serbia e ka miratuar Ligjin për Rininë në vitin 2011. Strategjia e Rinisë 2015-2025. përqendrohet në 11 përparësi. Dy të parat janë pjesëmarrja dhe rrjetëzimi i të rinjve, e cila duhet të krijojë mundësi më të mira për avokimin e organizateve rinore<sup>95</sup>. Strategjia përcakton gjithashtu mënyrat për pjesëmarrjen e të rinjve - duke krijuar një shoqatë apo koalicion. Pranë kësaj, ka zyra lokale dhe provinciale të rinisë që duhet të shërbejnë si një urë midis organizatave të rinisë dhe të rinjve dhe autoriteteve lokale e provinciale.

Organizata e kulmit e Rinisë së Serbisë (KOMS) është një organizatë e kulmit kombëtare që u themelua në vitin 2011. Ajo aktualisht përbëhet nga 109 organizata rinore. Ajo është një platformë avokimi që ka për qëllim përmirësimin e pozitës së rinisë dhe vepron si një lidhje midis rinisë, organizatave të cilat janë anëtare dhe vendim-marrësve të ndryshëm dhe ofruesve të programit dhe shërbimeve rinore (kryesisht shtetit dhe institucioneve të tij)<sup>96</sup>. Përkundër nëntë viteve të pranisë aktive dhe një baze të madhe anëtarësh, shteti njohu ligjërisht KOMS'in si një organizatë e kulmit kombëtare e cila nuk ishte deri në Gusht 2020. Bashkë me KOMS'in, Shoqata Kombëtare e Praktikës dhe Praktikantëve të Punës Rinore (NAPOR)<sup>97</sup> Shoqata Kombëtare e Zyrave Të Rinisë<sup>98</sup> janë tre shtyllat kryesore të sektorit të rinisë në Serbi<sup>99</sup>.

Kuvendi i Serbisë ka miratuar Ligjin për Vullnetarizmin në vitin 2010. Ndër dispozitat e tjera, Ligji parashikon tre kategori të aktiviteteve vullnetare; detyrimi që organizata mikpritëse të lidhë një marrëveshje me shkrim me vullnetarin; detyrimi që organizata mikpritëse të hyjë në regjistrin e organizatave vullnetare; detyrimi që organizata vullnetare të paraqesë një raport vjetor mbi aktivitetet e saj në Ministri; dhe përshkruan dënime të ashpra për shkeljen e ndonjë prej kërkesave të mësipërme. Të gjitha këto dispozita u ngjajnë ligjeve lidhur me vullnetarizmin në pjesën tjetër të BP6 dhe kanë një ndikim negativ mbi kulturën e vullnetarizmit.



90 Popadiq, Dragan; Pavloviq, Zoran & Mihailoviq Sreqko. (2018). Të rinjtë në Serbi 2018/2019. p. 57. Friedrich Ebert Stiftung

91 Ibid., p. 63

92 CeSID. (2019). Pozita dhe nevojat e të rinjve në Republikën e Serbisë. p. 88. CeSID

93 Stojanoviq, Boban & Ivkoviq, Aleksandar. (2020). Raport alternativ mbi pozicionin dhe nevojat e të rinjve në Republikën e Serbisë-viti 2020. p. 101. Organizatë e kulmit e të rinjve Serbë-KOMS.

94 Ibid., p. 117

95 Shkolla e Hapur e Beogradit. Kuadri strategjik i politikës rinore në Republikën e Serbisë - sfidat dhe perspektivat.

96 Faqja zyrtare e internetit KOMS: <http://koms.rs/en/organization/> Aksesuar: 10. shtator 2020.

97 Faqja zyrtare e internetit NAPOR: <http://www.napor.net/sajt/index.php/sr-yu/medjunarodni-projekti/about-napor> Aksesuar: 10. shtator 2020.

98 Shoqata Kombëtare e Zyrave të Rinisë: <https://asocijaciakzm.org/> Aksesuar: 10. shtator 2020.

99 Është e rëndësishme të theksohet se në vitin 2019, Qyteti i Novi Sadit, kryeqyteti i provincës Serbe të Vojvodinës, u zgjodh si Kryeqyteti Evropian i Rinisë, ku pjesëmarrja dhe politikat e të rinjve zhvillohen dhe testohen, të cilat mund të zbatohen më tej në vendet e tjera të Rajonit.

## NGA MEKANIZMAT NDËRKUFITARË NË ATO RAJONALE TË BASHKËPUNIMIT

Falë bashkëpunimit ndërkufitar të të gjitha qeverive të vendeve të BB6, një organizatë ndërkombëtare kushtuar të rinjve, Zyra Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO)<sup>100</sup>, u krijua në 2016. selia e RYCO'së është në Tiranë, por gjithashtu ka zyra në Beograd, Podgoricë, Prishtinë, Sarajevë dhe Shkup. Qëllimi i RYCO'së është "të promovojë frymën e pajtimit dhe bashkëpunimit midis të rinjve në rajon përmes programeve të shkëmbimit të të rinjve"<sup>101</sup>. Të 6 qeveritë janë zotuar të financojnë këtë organizatë.

RYCO mbështet aktivitete që mundësojnë bashkëpunim midis organizatave në të gjithë rajonin, kryesisht përmes projekteve të lëvizjes së të rinjve. Kjo u lejon të rinjve që të udhëtojnë dhe takojnë moshatarët nga i gjithë rajoni, me anë të cilës thyhen barrierat kombëtare dhe fetare. Vlen të përmendet gjithashtu se ky është mekanizmi i parë i tillë i formuar përmes një modeli të qeverisjes së përbashkët, në të cilin marrin pjesë të rinjtë rajonalë dhe përfaqësuesit e qeverisë.

Pranë mekanizmave, ka disa projekte dhe programe që synojnë një rrjetëzim më të madh midis të rinjve në rajone, të përqendruara kryesisht në punësimin e të rinjve:

- Organizatat e shoqërisë civile të Ballkanit Perëndimor për të mbështetur punësimin e të rinjve (*WEB4YES*) (Shkolla e hapur e Beogradit, Serbia)
- *Rinia Ballkanike për Evropën*, veçanërisht duke përfshirë *Shkollën Verore Politeia* (Qendra për Fondacionin e Demokracisë, Serbi)
- Karriera ime nga zeroja deri te heroi - forcimi i rrjetit të shoqatave të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor për të zbatuar një model "one-stop-shop" për punësimin e të rinjve i destinuar për vendet e ardhshme të punës 4.0. së revolucioneve dixhitale (Qendra për Punë Rinore, Mali i Zi)
- *Të rinjtë nga Ballkani: lidhja e arsimit, aftësive dhe potencialit të partneritetit në praktikat rajonale të punësimit* (BY LEAP) (Arritjet e të Rinjve, Serbi)
- *Projekti Laborator i Rinisë së Ballkanit Perëndimor* (Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal)
- WB&T for EmploYouth (Fondacioni Ana dhe Vlade Divac)



100 Si pasojë e Procesit të Berlinit.

101 Faqja zyrtare e internetit RYCO: [https://www.rycowb.org/?page\\_id=152](https://www.rycowb.org/?page_id=152). Aksesuar: 10. shtator 2020.

# PAMJE E PËRGJITHSHME E THELLË NË PËRFSHIRJEN E TË RINJVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR NË VENDIM-MARRJEN

## KUPTUESHMËRIA E PJESËMARRJES SË (TË RINJVE)

Siç u përmend më herët, 12 fokus grupe në 6 vende të Ballkanit Perëndimor mbledhën gjithsej 76 të rinj, të moshës 18 deri 30 vjeç. Të gjithë ata kanë fituar të paktën një përvojë me proceset e vendim-marrjes, pavarësisht nëse ata marrin pjesë drejtpërdrejt ose janë të njohur me to, duke organizuar ose monitoruar procese të tilla. Kjo është e rëndësishme të theksohet, sepse shumica e të rinjve nga BP6, siç u përmend në kapitujt e mëparshëm, nuk kanë përvojë të tillë. Ky është me të vërtetë një nga kufizimet e këtij studimi - ajo ofron një perspektivë të brendshme për procesin, por kuptueshmëria e këtyre proceseve nga shumica e të rinjve mbetet e panjohur. Megjithatë, për të kuptuar se si funksionon sistemi, është më mirë të pyeten ato që kanë njohuri dhe/ose përvojë me pjesëmarrjen.

Edhe pse të gjithë pjesëmarrësit e FG kishin të paktën një përvojë të caktuar ose njohuri mbi pjesëmarrjen e të rinjve (shumica e tyre kishin mjaft përvojë) që praktikoheshin në nivel lokal dhe /ose kombëtar, dhe megjithëse ligjet dhe mekanizmat ekzistues janë të ngjashëm në të gjithë rajonin ose përdorin terminologji të ngjashme, pjesëmarrja nuk interpretohet në mënyrë identike në grup, edhe pse kuptueshmëria duket se vjen nga i njëjti vend. Në një mënyrë, pjesëmarrja përjetohet si një pjesëmarrje e drejtpërdrejtë në vendim-marrje në nivel lokal ose kombëtar - për shembull, pjesëmarrja në një grup pune të ngarkuar me zhvillimin e një plani lokal të veprimit për rininë: *Përvoja e shkrimit e atij plani lokal (në vitin 2009) ka qenë e bukur. Ja çfarë ndodhi - të gjitha organizatat vullnetare që ishin aktive në qytetin e Pançevos u mbledhën në atë kohë, të gjithë presidentët, krerët e atyre organizatave u mbledhën dhe ne regjistruam një organizatë të kulmit lokale ... Kur e shkruam atë Plan Veprimi Lokal, u shfaqën si një organizatë e vetme, unike, jo si një milion njerëz të ndryshëm që ishin të ndarë në një milion organizata të ndryshme. Ajo ishte vërtet një përvojë e mrekullueshme.. Për fat të keq, vajza që udhëhoqi të gjithë procesin (nga Zyra Lokale e Rinisë) u largua, disa njerëz të rinj erdhën dhe gjithçka filloi të prishej (në aspektin e aktivitetit dhe motivimit). Hajde tani le t'i motivojmë të rinjtë që përsëri të aktivizohen!* Në mënyrë tjetër, pjesëmarrja kuptohet mjaft gjerësisht dhe më pak formalisht. Për shembull, poashtu edhe pjesëmarrja në FG në këtë hulumtim është përjetuar si një lloj pjesëmarrjeje (me kuptueshmëri dhe shpresë se kontributi i tyre në gjetjet dhe rekomandimet e këtij hulumtimi mund të ketë një ndikim indirekt) apo gjithashtu edhe pjesëmarrje në ad-hoc ose veprime të rrugës të planifikuara. Kur iu kërkua të jepte një shembull për pjesëmarrjen e të rinjve, një i anketuar u përgjigj: *Në lagjen time, disa të rinj nisën një nismë qytetare disa vjet më parë për t' u përpjekur të tërheqin vëmendjen e vendim-marrësve vendas ndaj problemit të gjendjes së keqe të rrugës kryesore. Ndërsa rruga ishte plot me gungë dhe vrime, ata mbollën lule në to dhe ftuan gazetarët të raportonin mbi të. Kjo u takua me mjaft publicitet dhe vendim-marrësit vendosën ta asfaltojnë atë rrugë. Ky shembull tërheq vëmendjen në faktin se aktivizmi, në çfarëdo forme - i planifikuar ose spontan, politik ose humanitar (një pjesëmarrës dha një shembull të veprimit në rrugë të organizuar nga zyra lokale e Kryqit të Kuq), është i lidhur ngushtë me pjesëmarrjen. Koncepti i vullnetarizmit gjithashtu nuk mund të ndahet lehtë nga pjesëmarrja. Ekziston një kuptim më i gjerë, më i mençur i pjesëmarrjes që merr parasysh se mund të nënkuptojë një kontribut të drejtpërdrejtë - si propozimi i amandmanit por edhe që nuk ka pse të jetë pjesë e ndonjë forme të veçantë dhe të institucionalizuar - pjesëmarrja është gjithashtu një aksion në rrugë, tubim apo fushatë në mediat sociale, sepse lejon që zëri i dikujt të dëgjohet.*





Shembuj të mirë për të kuptuar pjesëmarrjen erdhën nga përgjigje të ndryshme në pyetjen: *Si do ta shpjegonit se çfarë është pjesëmarrja një 10-vjeçarit?* Një nga idetë më të shpeshta në shumë FG ishte që loja e një fëmije, siç është ajo përvoja e tij, të ceket si shembull i pjesëmarrjes: *Unë do të provoja me një shembull banal, si një lojë që luajnë fëmijët, dhe do ta shpjegoja atë në këtë mënyrë: "Shikoni, ajo lojë nuk duhet thjesht t'u servohet juve: Le të shohim se si do ta paramendonit atë lojë, çfarë do të ndryshonit ose shtonit ose të bënit ndryshe".*

Ky është një shembull i mirë se si pjesëmarrësit e FG-së e kuptojnë pjesëmarrjen dhe çfarë e bën një aktivist - kur të lëmë mënjanë format dhe mekanizmat (dhe tek ato do të vijmë më vonë), për një aktivist ose për pjesëmarrje (aktive), është shumë e rëndësishme (për një të ri) të interesohet për pyetje sociale që janë të ndjeshme, të informuara rreth temave aktuale dhe të formojë një opinion kritik. I riu aktiv është ai që, kur merr informacionin, nuk e merr si të mirëqenë, por e merr duke e kaluar nëpër disa filtra të tij, pastaj formon qëndrimin e tij dhe reagon në bazë të tij - si anëtar aktiv i shoqërisë. Mendoj se ky interes është shumë i rëndësishëm dhe të menduarit dhe suditja kritike është gjithashtu e rëndësishme në çdo aktivitet të çdo të riu. Ky kuptim i gjerë i pjesëmarrjes dhe pamjeve dhe formave të ndryshme gjë që ai nënkupton është i rëndësishëm për t'u kujtuar dhe marrë parasysh gjatë analizimit të aspekteve të tij të tjerë të rëndësishëm, të tilla si motivimi apo mekanizmat, apo se si të rinjtë i përjetojnë institucionet (dhe shoqërinë në përgjithësi) kur marrin në konsideratë pjesëmarrjen. Bazuar në përgjigjet dhe përvojat e ndara nga pjesëmarrësit, ne mund të përqijemi të përcaktojmë aktivizmin, duke pasur parasysh se ai është i lidhur ngushtë me pjesëmarrjen - mund të thuhet me siguri se çdo rast i aktivizmit është pjesëmarrje: aktivizëm do të thotë të marrësh një qëndrim publik dhe të merresh aktivitet në lidhje me një pyetje me rëndësi publike.

Se si e kuptojnë pjesëmarrjen të rinjtë dhe cilat janë kufijtë brenda të cilave i vendosin pjesëmarrjen dhe si mendojnë për të njëjtën, janë pyetje që na çojnë në pyetjen e motivimit dhe arsyes pse një i ri apo e re dëshiron të marrë pjesë fare. Motivimi mund të analizohet ekskluzivisht nga perspektiva psikologjike (e brendshme), por kjo qasje është jashtë fushës së këtij studimi. Si i kemi marrë pikëpamjet e pasura personale dhe dëshmitë nga pjesëmarrësit, analizo do të përqëndrohet në rrethanat dhe proceset e jashtme dhe ngjarjet që kontribuojnë në motivimin për pjesëmarrje, dhe për atë se si rinia po i trajton ato dhe si ajo e profilizon këtë kontekst.



## MOTIVIMI - ÇFARË E INKURAJON PJESËMARRJEN E TË RINJVE?

Natyrisht, ka një numër arsyes dhe motivesh për kyçjen e të rinjve, por duket se ka disa arsye mbizotëruese brenda grupit që kemi anketuar. Një prej tyre është nevoja për të gjetur një mënyrë për të hulumtuar dhe mësuar, të jetë kurioz dhe të shpreh krijimtarinë e tij. Një nga mënyrat është që kur nuk ka mundësi të institucionalizuara (të institucionalizuara në një kuptim të gjerë, formale apo joformale), ato të gjeihen dhe krijohen individualisht ose kolektivisht. Ky citat i shkurtër e përmbledh atë bukur: *Motivimi, në të paktën, veçanërisht nëse dikush jeton në një komunitet të vogël, buron nga dëshira për të mësuar rreth gjërave dhe fenomeneve. Njeriu nuk ka qas shumë mundësi për këtë, veçanërisht kur ne konsiderojmë situatën politike dhe partitë politike që kufizojnë mundësitë dhe ju kërkojnë të "bëheni një anëtar i një partie politike së pari" dhe të ngjashme. Kështu që unë vërtet mendoj, duke marrë parasysh se sa të informuar jemi, se ne mund ta shmangim këtë proces (të bashkimit me partitë politike) dhe të shkojmë në atë rrugë në mënyrë të pavarur, për t'u zhvilluar dhe të kemi sukses.*

Mund të jetë një ekzagjerim të thuhet që të qenurit aktiv dhe të marrësh pjesë se është ngjithëse, por duket se kur të rinjtë bëhen aktivë, ekziston dëshira që të kyçen moshatarët dhe t'u tregohen atyre gjërat e këndshme që mund të bëjnë kur të kyçen. Kjo gjithashtu bëhet në mënyrë indirekte, vetëm me aktivitet dhe duke treguar se çfarë është pjesëmarrja dhe cilat janë dobietë si për të riun ashtu edhe për komunitetin: *Në lidhje me këtë (motivimi) dhe në relacion me të rinjtë aktivë (dhe personalisht besoj se i ka mjaft më shumë se sa të rinj pasiv): sepse ne punojmë në sektorë të ndryshëm dhe (jemi në gjendje të) influencojmë gjërat, ne i drejtojmë miqtë dhe të njohurit tanë (drejt aktivizmit). Çdo ditë shkojmë një hap më tej në kyçjen e tyre. Nëse asgjë tjetër, ne u japim atyre informacione se diçka e tillë ekziston. Dhe ata që nuk do të kyçen konkretisht do të mësojnë së paku për mundësinë, dhe ndoshta dikush tjetër që ata njohin do të kyçet.*

Kjo na sjell në një aspekt shumë të rëndësishëm të motivimit - pse të rinjtë përfshihen në përgjithësi dhe pse qëndrojnë aktivë: ka të bëjë me mbështetjen e komunitetit të tyre, bashkëmoshatarëve, shkollës, prindërve: *Esencialisht është e nevojshme që dikush ose diçka në komunitet t'i shtyjë të rinjtë (kah ajo të jenë aktiv). Motivimi i cili vjen prej të tjerëve është po aq e rëndësishme sikur motivimi ynë personal. Është shumë e rëndësishme që dikush të na udhëzojë: "T'a bëjmë këtë, t'a ndryshojmë atë". Ky shkëmbim në BiH, midis moderatorëve të FG'ëve dhe disa pjesëmarrësve, përshkruan më tej rëndësinë e mbështetjes. Edhe në një fokus grup i cili përbëhet nga pjesëmarrësit që ndoshta nuk janë takuar kurrë më parë dhe kanë prejardhje të ndryshme (të paktën etnike dhe fetare), mirëkuptimi reciprok dhe ndjenja e të përkaturit kanë dhënë mbështetje dhe ende i kanë motivuar njerëzit.*

**MODERATORI (M):** Çka j'u motivon? A j'u ka tërhequr dikush apo vetë keni kërkuar hapësirë për të shprehur disa nga idetë tuaja se si duhet të duket diçka në shoqëri? Si j'u shohin të tjerët (të cilët nuk janë aktiv)?

**I ANKETUARI 1 (I1):** Ka gjithmonë njerëz që j'u mbështesin dhe ata që nuk e bëjnë atë, që mendojnë se jeni duke aktruar apo diçka e tillë. Dhe duhet shumë guxim, pavarësisht nëse duam ta pranojmë apo jo.

**M:** Çka j'u motivon, cili është motivi juaj? Pse nuk dorëzoheni?

**I2:** Hm, çka më motivon? Që ta bëjë komunitetin tim lokal ose tërë Bosnjë dhe Hercegovinë një vend më të mirë për veten time dhe për të tjerët. Nëse unë jam 100% ok, do të bëj diçka të dobishme dhe pozitive në mënyrë që dhe të tjerët rreth meje të jenë mirë.

**I3:** Mendoj se përgjithësisht na mungon shumë kurajo dhe guxim për të thënë: "Hej, tani është koha jonë". Na mungon ajo, momenti në të cilin e kuptojmë atë zë i cili thotë: „Ne do t'a bëjmë atë!". Por mendoj se ka shumë potencial. Unë i dëgjoj këta të rinj të tjerë dhe me të vërtetë e di që mund t'a bëjmë; na duhet vetëm pak.

**M:** Po, i anketuari 4, na thoni, Ju lutem!

**R4:** Jam i kënaqur që dëgjoj diçka si kjo nga i anketuari 3. E thënë thjesht, kisha nevojë për dikë që të më shkundte dhe të më thoshte: "Eja këtu t'a shohësh këtë, ndoshta kjo është po ajo që të duhet". Unë jam ajo që jam sot, dhe tani unë i inkurajoj të tjerët. Komunitetet tona janë ashtu siç janë, prandaj përpiqem, sa më shumë që të jetë e mundur, të mos jem i rrethuar nga energjia negative. Mendohej të shoqërohem me njerëz me të njëjtin mendim që kërkojnë mënyra për të kontribuar në komunitetin e tyre. Pa marrë parasysh se çfarë, gjithmonë do të ketë nga ata që do të përpiqen të j'u ngadalësojnë ose të mos j'u lejojnë të përparoni, por është e rëndësishme për mua të mos lejoj njerëz të tillë të më afrohen.



Motivimi për veprim dhe tentim të pjesëmarrjes në proceset e vendim-marrjes ndonjëherë buron nga ndjenja e pakënaqësisë së madhe në pamje të situatës në shoqëri në tërësi ose në një komunitet të caktuar ose institucion, veçanërisht kur dihet se gjërat mund të jenë më të mirë. Po edhe po të buroja nga kjo ndjenjë negative, përsëri ekziston një mirëkuptim se motivimi për pjesëmarrje i nevojitet mbështetja e nevojitshme dhe inkurajim nga të tjerët:

I1: Mirë, ajo që kam parë (ajo që i motivon të tjerët) është t'u them atyre se kush është fajtori për situatën në të cilën gjenden. Për shembull, kur jam me të rinjtë, jo si pjesë e një projekti, kur vetëm flasim për pyetjet e ndryshme, dëgjoj se ata janë të shqetësuar për shkak të shumë gjërave. Ata gjithashtu tentojnë të fajësojnë autoritetet kombëtare për të gjitha problemet e tyre. Ata nuk e dinë që qeveria lokale është gjithashtu përgjegjëse, mentaliteti i njerëzve dhe sistemi i brishtë në të cilin jetojmë është gjithashtu fajtor. Ndoshta nuk është vetëm qeveria fajtorë, por është edhe faji ynë. Unë shoh se shumë njerëz marrin përgjegjësi të ndryshme por pa ditur si t'a bëjnë punën. Për shembull, shumë profesorë që thjesht nuk dinë t'a bëjnë punën. Dikush mund të jetë ekspert i mrekullueshëm, por nuk di si t'ua transmetojë studentëve njohuritë që ai ka. Ajo është problemi i madh. Dhe të rinjtë kanë edhe probleme familjare, financiare, probleme me profesorë, ose ndonjëherë edhe probleme personale, e dini ...

M: Pra, pjesëmarrja vjen nga rebelimi?

I2: Ashtu, siç tha ai. Të rinjtë janë shumë të revoltuar dhe nëse do të dinin se çfarë po ndodhte, kush e di se çfarë do të bënin. Ndoshta duhet t'u themi atyre që të ankohen, të avokojnë, sepse ajo është e drejta e tyre. Nga ana tjetër, kemi dhe fëmijët njerëz të cilët janë të privilegjuar, të cilët janë shumë të pasur dhe nuk i kanë këto probleme.

M: Dhe ato (ato që janë të revoltuar) nuk marrin pjesë?

I2: Po, nuk marrin pjesë.

M: Dhe kur ata do të ishin aktiv?

I2: Shumica e tyre janë të revoltuar dhe ne kemi një mundësi të mirë, ndoshta t'i informojmë ata për problemet, për gjërat që mund t'i bëjnë. Le t'u themi atyre se ata mund të ndryshojnë diçka dhe si ta bëjnë atë. Le t'u themi se nuk mund të presin që të ndodhë ndryshimi nëse nuk lëvizin. Unë u them atyre që të angazhohen, të organizohen, t'i nisin protestat dhe tubimet ose të gjejnë ndonjë mënyrë tjetër për të shprehur pakënaqësinë e tyre. Unë u them atyre si t'a bëjnë këtë, të zgjedhin një mënyrë demokratike. Dhe ata e bëjnë atë ndonjëherë, e dini, ndonjëherë ata përpiqen, ndonjëherë edhe... Për shembull, kemi shumë iniciativë që i ndajmë në Facebook, dhe disa kanë qenë të mira. Shpesh sugjeroj: "Në rregull, kur keni diçka, disa informata, dërgojeni ata, ngrini zërin dhe dërgojeni të tjerëve sa më shpejt të jetë e mundur". Dhe ata po e shpallin atë menjëherë.

Sigurisht, mosbesimi dhe pakënaqësia nuk provokojnë çdo herë një reagim. Edhe të rinjtë me më pak përvojë janë të zhgënjyer kur shohin se shoqëria në të cilën ata jetojnë është në një status quo, dhe kjo mund t'i pasivizojë ata:

M: Çfarë Ju motivon, çfarë për shembull Ju përfshin në kyçe ose të insistoni që qeveria të kyçet në konsultim. Për shembull, kur u miratua Ligji për rininë (Maqedonia e Veriut), kishte shumë të rinj të përfshirë në procesin e konsultimit. Çka do t'ju motivonte të kyçeni?

I1: Njerëz më kompetentë në institucione, në parti politike... Njerëzit do të kishin më shumë konfidencë. Mendoj se shumica e njerëzve nuk u besojnë atyre dhe mendoj se procesi nuk do të përfundojë ashtu siç do të dëshironim të mbaronte. Në fund...

M:... Të tjerët do të vendosin?

I1: Ata do të marrin vendime, vendime ndër-partiake, vendime politike. Ato i përfaqësojnë interesat e ndryshëm. Nuk e di... Kurrë nuk është e sigurt, për shembull, kur diçka buron nga të rinjtë, një iniciativë apo diçka e ngjashme, ndonjë dëshirë për të ndryshuar diçka, nëse ajo do të zbatohet në masë të plotë.

M: A j'u demotivon kjo?

I1: Po. Mendoj se zëri i të rinjve nuk do të dëgjohet si duhet, por ata vetëm do të shfrytëzohen. Jo vetëm të rinjtë, por të gjithë, por në këtë rast njerëzit e rinj. Në përgjithësi, unë nuk u besoj institucioneve, partive politike dhe të gjithë vendim-marrësve, organeve legjislative.

M: Më lejoni t'ju lexoj atë që I2 e ka ndarë përmes bisedës: "Unë personalisht nuk e shoh veten këtu, sepse këtu mund të përparojnë vetëm njerëzit që janë fëmijë "të dikujt" dhe kështu me radhë. Unë do të filloj me shoqërinë e rrezikuar, sepse këtyre të rinjve nuk mund t'u sigurohet punë adekuate sepse ekziston një diskriminim i madh. Edhe sikur të fillonim një iniciativë për të ndaluar atë diskriminim, askush nuk do të na dëgjonte. Para zgjedhjeve, partitë politike u premtojnë gjithçka, vetëm për të marrë votën e tyre, por për ata asgjë hiç nuk bëhet.

I3: Nuk pajtohem. Ky është mendimi i tij. Unë jam, prapsepap, i kushtuar përpjekjes për të ndryshuar standardet në politikë, për ti ngritë ato pak së paku. Që njerëzit e rinj, që besojnë se diçka duhet përmirësuar, të paktën të luftojnë pak për të. Sepse, askush nuk do të na japë asgjë, sidomos ata njerëz që i konsiderojmë të paaftë.

Ne i kritikojmë ata, por ne nuk jemi duke bërë asgjë, ne vetëm ulemi anash dhe duam të hikim nga këtu. Dhe pastaj nuk do të mbetet asgjë nga ky vend.

Njëherë kur ekziston motivimi, nga kudo që të vije ai, të rinjtë përdorin mënyra të ndryshme për të vepruar dhe për të marrë pjesë në proceset që ata i konsiderojnë të rëndësishme dhe domethënëse. Mbi mirëkuptimin e gjerë të paraqitur më parë të pjesëmarrjes, vjen një sërë mjetesh dhe formash që të rinjtë kanë në dispozicion të tyre - disa tashmë ekzistuese, disa të projektuara për t'u shërbyer nevojave të tyre.

## PJESËMARRJA E TË RINJVE - MJETET DHE FORMAT, DHE INSTITUCIONET

Në shumicën e fokus grupeve, është i theksuar dallimi i qartë midis mënyrës zyrtare dhe joformale në të cilin të rinjtë mund të kycen dhe avantazheve dhe disavantazheve të të dyve. Gjithashtu, është njohur qartë nevoja dhe kuptimi se mjetet dhe format janë më të mira nëse lejojnë shprehjen e krijimtarisë, edhe nëse ajo nuk ofron pjesëmarrje më efikase ose efektive. Citati i pasardhshëm na kujton qartë për gjetjen nga kapitulli i mëparshëm për atë se si mbështetja është e rëndësishme për motivimin e pjesëmarrjes, dhe siguron pamje të përgjithshme dhe hyrje në disa mekanizma të ndryshëm të pjesëmarrjes. *Deshta të shtoj diçka, pasi po flasim për mekanizma të caktuar. Kur ne (organizata rinore) duam t'i njoftojmë të rinjtë me atë se çka është pjesëmarrja, si të marrin pjesë... ne përqendrohemi në punëtori të ndryshme dhe edukimin e kolegëve si hapi i parë në fuqizimin për të filluar një iniciativë. Sepse më shpesh, pasi t'a kalojnë atë, kur janë edukatorë, trajnerë dhe kështu me rradhë, ata i ndërpusin iniciativat e tyre dhe fillojnë të besojnë në aktivizëm dhe avokim, dhe më vonë nganjëherë anëtarësohen në disa organizata. Ose ata nuk bashkangjiten, gjithçka varet, por ata vërtet besojnë në atë që thonë, ata vërtet besojnë në ndonjë qëllim që ndajnë së bashku. Kështu që unë mendoj se mësimi i moshatarëve, si diçka që kam bërë për mjaft kohë, është një mënyrë e mirë për kycjen e të rinjve... Nga ana tjetër, unë do të doja të përmendja mekanizmin që është ende duke u zhvilluar në vendin tonë (Serbi), por unë pata mundësinë të punoj mbi fusjen e saj, dhe ky është "dialogu i strukturuar". Nuk e di nëse dikush ka dëgjuar për këtë, ajo është një mekanizëm i veçantë për kycjen e të rinjve në dialog me vendim-marrësit. Ai po zhvillohet aktualisht në Serbi dhe shpresoj se do të zhvillohet më shumë në periudhën e ardhshme, sepse është një shembull i mirë se si funksionon mekanizmi i pjesëmarrjeve. Përndryshe, ky është një mekanizëm që është transferuar këtu nga BE'ja. Ka disa mekanizma që janë hartuar shumë mirë në BE. Për mendimin tim, si dhe për ekspertët e tjerë, këta (mekanizma) funksionojnë vërtet dhe shpresoj se do të jemi në gjendje t'i transferojmë këtu. Kjo është një sfidë mjaft e madhe, sepse këtu dhe në BE, kur flasim për kycjen e të rinjve, situata është krejtësisht e ndryshme.*

Të anketuarit janë të vetëdijshëm për mekanizmat ekzistues zyrtarë dhe dobëtë e tyre, të tilla si legjitimitetin, efikasitetin ose përgjegjësinë që ato ofrojnë. Por prap se prap, ata janë gjithashtu të vetëdijshëm se nganjëherë këta mekanizma nuk funksionojnë fare, ose nuk funksionojnë në masën që duhet. Ose që (të rinjtë) nuk e dinë fare që ekzistojnë mekanizma të caktuar dhe si t'i përdorin ato:

*I1: Ka Këshilla për rininë dhe ato duhet të funksionojnë dhe përmes tyre të rinjtë mund të komunikojnë me publikun. Unë, ashtu si ai (i anketuari i mëparshëm), sigurisht që nuk do të ftohem në një diskutim (në lidhje me zgjidhjen e pyetjeve të disa studentëve në lidhje me provimet), por një përfaqësuesi i Këshillit mund të ftohet për të shprehur pikëpamjet tona. Të rinjtë mund t'i rregullojnë gjërat internisht, por zakonisht ka dikush që nuk pajtohet ose mendon se ajo që vendoset nuk është në rregull ose dëshiron të propozojë... Gjithmonë është kështu, dhe do të jetë gjithmonë. Dhe kjo është arsyeja pse unë them që përfaqësimi është i rëndësishëm, si këshilli rinor - ai do të përfaqësojë pikëpamjet e të rinjve dhe duhet të jetë funksional. Unë kisha një projekt të vogël, ai ishte në Krivogaštani, në Prilep. Të rinjtë u përfshinë në formimin e këshillave për rininë, përmes të cilave ata arritën të veprojnë, domethënë të propozojnë publikisht zgjidhje të ndryshme...*

*M: Faleminderit. Mendoj se I2'i deshti të thoshte diçka.*

*I2: Duhet të pajtohem me I1'in, sepse në një periudhë më të gjatë kur të rinjtë dëshironin të shprehnin mendimin e tyre, ndonjëherë ajo do të ishte paksa ad hoc dhe pa analizë se çfarë efekte do të prodhojë ai vendim ose kërkesë. Ata mendojnë vetëm për një pyetje të veçantë, në kohë të caktuar. Si, për shembull, me ato provimet universitare. Të gjithë donin të dilnin në provim fizikisht dhe pas një muaji e gjysmë, kur provimet filluan të caktoheshin, ata u kujtuan se duhet të udhëtonin, se nuk do të ishin në gjendje të ishin në klasë nëse do të kishte më shumë se dhjetë studentë, do të duhet nodshta të dalin në atë provim natës... Kështu që unë mendoj se të rinjtë duan të marrin pjesë në vendim-marrje, por ne (punëtorët rinor) duhet t'u ndihmojmë pak, të sigurojmë mekanizma dhe t'u tregojmë atyre se si të përfaqësohen ose të përfaqësojnë, në mënyrë që të mos humbasin legjitimitetin...*

*Dhe kur bëhet fjalë për mekanizmat, ka shumë mekanizma. Ne mund të fillojmë me këshillat lokale të rinisë për të cilët po fliste I1'i; duhet të ketë një rregullore lokale për të rinjtë në secilën komunë dhe komuna duhet t'i mbështesë ata; mandej Këshilli Kombëtar i Rinisë - ku të gjitha organizatat rinore duhet të përfaqësohen; organizatat lokale dhe asamblëte universitare ...*

*Pra, këta mekanizma të pjesëmarrjes, dhe ne si përfaqësues dhe bartës të mekanizmave të pjesëmarrjes, duhet të jemi më të njohur në mesin e të rinjve, në mënyrë që të rinjtë të mund të vijnë tek ne, dhe ne pastaj të përfaqësojmë mendimet e tyre. Dhe nëse ndonjë nga të rinjtë... nuk dëshiron të marrë pjesë përmes nesh, sigurisht aty është ENER (Regjistri Kombëtar Elektronik i Unifikuar i Rregullore të Republikës së Maqedonisë Veriore), si një platformë përmes së cilës çdokush së paku mund të shpreh mendimin e vetë.*

*M: Sa të rinj dinë për ENER'in?*

*I2: Epo, sinqerisht, në këtë grup (fokus) ndoshta Ti dhe unë, dhe jashtë këtij grupi ndoshta 0,01% të njerëzve.*

*M: Mendoj se edhe I1 edhe I3 kanë konfirmuar se e dinë çka është ENER'i. Po, ajo është një mekanizëm shumë i mirë për kycjen e publikut në proces. Nëse përdoret si duhet, mund të jetë shumë efektive.*

*I3: Do të doja gjithashtu të shtoja, nëse ajo nuk është problem, meqë përmendëm këshillat e të rinjve, këshilli kombëtar... Mendoj se është një problem serioz që këshillat e të rinjve nuk funksionojnë. Mendoj, ata nuk funksionojnë, jo gjithkund. Kur funksionojnë, dhe ajo është përjashtim, shumica e këshilleve nuk e dinë me të vërtetë se për çfarë bëhet fjalë dhe cili duhet të jetë qëllimi primar i këshillit të rinisë. Unë mund të flas për qytetin tim - ne (organizata rinore) bashkëpunojmë me këshillin rinor dhe gjithë ajo, por ata nuk e dinë qëllimin e tyre fillestar, ata nuk e dinë se çfarë është këshilli i rinisë dhe cilat janë funksionet e këshillit të rinisë, çfarë duhet të bëjnë.*





Situata duket të jetë e ngjashme në Serbi: Unë do të doja të përfundoja, përveç kësaj, se megjithëse ka disa mekanizma nëpërmjet institucioneve që përdoren dhe eksistojnë një qasje joformale apo arsimim i moshatarëve dhe punëtori të ndryshme dhe angazhimi i të rinjve në mënyra të tilla që më vonë po ato janë ata që drejtojnë disa nisma. Mendoj se një qasje më informale është jashtëzakonisht e rëndësishme sepse siguron një lloj vazhdimësie. Problemi më i madh kur bëhet fjalë për ndonjë mbështetje institucionale, të paktën nga përvoja ime ose rrethi i njerëzve në të cilin lëviz, është se ai nuk është i vazhdueshëm. Një qeveri vjen dhe zbaton një teknikë, dhe pastaj qeveria ndryshon, kështu që ajo teknika nuk vlen më. Kam hasur në situata ku të rinjtë, të cilët nuk janë tepër të kyçur (të inkuadruar) në vendim-marrje, mësojnë dhe mësohen me një sistem përmes të cilit në një farë mënyre mund të marrin vendime, të ushtrojnë njëfarë ndikimi, fillojnë të besojnë se po vendosin për gjërat - por pas zgjedhjeve të ardhshme ai sistem nuk vlen më.

Ky citat i mëparshëm tregon gjithashtu një tipar të papritur të mekanizmave informalë të pjesëmarrjes - kontinuiteti, i cili do të pritej nga ai zyrtar, i institucionalizuar. Gjithashtu, duket se mjetet joformale ose formale që mundësojnë shprehjen e krijimtarisë përjetohen më pozitivisht. Ata janë më spontanë dhe të rinjtë kanë një ndjenjë më të fortë të pronësisë sepse e krijojnë atë nga nevoja e tyre: Ne donim implementonim një ide në komunitetin në të cilin jetojmë, dhe ata (qeveria lokale) thanë se do të mbulonin financat dhe logjistikën, kështu që të rinjtë u aktivizuan. Ose, për shembull, keni Këshilla të nxënësve. Ata zakonisht marrin iniciativë, zbulojnë vetë shkollën, vizatojnë... Sidomos në Ferizaj kemi "Mural Fest'in", i cili në fakt tashmë po ndodh intensivisht në komunat e tjera, madje edhe në Prishtinë. Përmes tij, ne zëvendësojmë të gjitha fasadat e dëmtuara me afreske, dhe kështu pasurojmë hapësirën publike. Dhe nëpërmjet tyre, nëpërmjet formave të artit, të rinjtë, natyrisht, shpesh shprehin pakënaqësinë e tyre ndaj politikave publike. Ka një shembull tjetër i mirë nga Kosova dhe Metohia që ka bashkuar të rinjtë për pyetje të ngjashme: dekorimin e qytetit për pushimet dimërore. Kjo tregon se si të rinjtë mund të angazhohen më shumë nëse u jepen mundësi inovative për konsultim dhe aktivizim:

I1: Ne gjithashtu merremi me pyetje që nuk janë pjesë e projektit. Për shembull, si anëtare e një organizate, projekti për të cilin po punoj ka të bëjë me ekstremizmin, por unë jam gjithashtu një ekologe dhe një feministe dhe jam aktive në shumë pyetje. Ky shembull mund të tingëllojë qesharak, por kjo nuk ishte qesharake për ne. Bëhet fjalë për dekorimin e qytetit për Vitin e Ri, gjë që nuk u bë (nga autoritetet), madje biseduam me organizata të shoqërisë civile dhe askush nuk donte të reagojë. Ashtu fillova të postoja poste në rrjetin social dhe fillova t'i "sulmoj" autoritetet komunale. Përdora satirë dhe kështu me rradhë... Dhe në fund ajo u bë (qyteti u dekorua). Deri kohët e fundit, ata më quanin "aktivist i Vitit të Ri". Pra, ky është një shembull...

M: A t'u shoqëruan të rinjtë në këtë nismë?

I1: Mendoj se po, edhe ato janë tallur, kanë komentuar...

Një shembull tjetër nga Serbia flet për natyrën spontane të mekanizmave të tillë dhe sa të gjerë dhe gjithëpërfshirës mund të jenë ata: Do të thosha definitivisht që të rinjtë mund të mos jenë të vetëdijshëm se sa e rëndësishme është pjesëmarrja e tyre dhe se mekanizmi informal që përmendët është shumë i rëndësishëm, të paktën si një hap fillestar për të treguar një iniciativë. Mbay mend një situatë nga një protestë kur një i ri që kishte 17 ose 18 vjeç u arrestua dhe kur e gjithë shkolla doli të protestonte për shkak të kësaj. U emocionova me iniciativën e tyre dhe se si ata e kanë bërë atë me qetësi. Unë mendoj se iniciativa të tilla (informale) duhet të bëhen një qasje e zakonshme për disa probleme të tjera me të cilat përballen të rinjtë, madje edhe në shkollën e mesme. Për shembull, nëse janë të pakënaqur me mësuesin, ata mund të përpiqen ta zgjidhin problemin në një mënyrë informale. E di (pakënaqësia me mësuesin), mbase është paksa një shembull banal, por në atë nivel të shkollës së mesme - nëse diçka e tillë zhvillohet tek një njeri në shkollën e mesme, atëherë kur të rritet ai do të kuptojë disa gjëra dhe kjo do të jetë më e lehtë për të që të angazhohet. Unë do të thoja që për të rinjtë e moshës 15 deri në 20 vjeç, mënyra informale e funksionimit dhe organizimit është shumë e rëndësishme. Dhe shpresoj, si dhe ai (i anketuari i mëparshëm), që këta mekanizma do të përmirësohen në të ardhmen. Novi Sad'i ishte padyshim një mënyrë e mirë për këtë. Shpresoj se do të kemi diçka të ngjashme dhe në Beograd.

Shumë shembuj të mekanizmave informalë gjatë diskutimeve në FG, përfshirë ato të paraqitura këtu, bazohen në përdorimin e Internetit. Është e sigurt që edhe shembulli i fundit i paraqitur këtu - në lidhje me protestën e studentëve të shkollave të mesme - ishte organizuar të paktën disi përmes internetit. Kjo është e pashmangëshme duke ditur faktin se të rinjtë që përfshihen në studim dhe të rinjtë për të cilët pjesëmarrësit në FG po flasin janë indigenë dixhitalë. Kjo hap një seri krejt të re pyetjesh rreth asaj se sa formal janë mekanizmat e pjesëmarrjes institucionale, përfshirës duke pasur parasysh që format dhe zakonet e komunikimit të të rinjve nuk përshtaten në të vërtetë me mënyrën e vendosjes së institucioneve dhe duan të komunikojnë. Fatkeqësisht, kjo është jashtë fushës së veprimt, por të anketuarit i nisën disa pyetje të rëndësishme kur flisnin për komunikimin në internet në përgjithësi: sigurinë, keqkuptimin dhe lajmet e rreme. Përgjatë grupeve padyshim ekzistojnë pikëpamjet e ndryshme në lidhje me pro dhe kundrat e përdorimit të internetit, por ka padyshim vetëdije dhe disa shqetësime në lidhje me rreziqet e përdorimit të internetit:

M: Pyetje për të gjithë: cilat janë anët e këqija, e cila të mira kur interneti shfrytëzohet për pjesëmarrjen e të rinjve?

I1: Nuk jam i sigurt. Siç thotë kolegu im, meqenëse nuk e krijuam ne atë, për të mos zgjedhur shpesh se si do ta përdorim, por jemi të detyruar t'a përdorim atë në një mënyrë të caktuar. Megjithatë, ajo është një makinë për larjen e trurit e cila është duke punuar aktivisht mbi të (larje truri) për më shumë se një dekadë...

M: I2, Ju lutem, më thuani, çka shihni si pozitive dhe a mund interneti të ketë disa efekte pozitive?

I2: Mundet, për sa kohë që ka njerëz të lirë që e përdorin atë. Sa më shumë që njerëzit ishin të lirë në internet. Por është e qartë që Interneti është bërë shumë më pak i lirë në dhjetë vitet e fundit sesa ishte kur u lançua. Duke filluar me disa gjëra të thjeshta: të gjithë ju ndoshta e mbani mend kur YouTube nuk kishte komente, asgjë nuk ju çoi në një video, ju thjesht endët në atë platformë elektronike dhe mundeshit të merrni gjithçka që dëshironit, dhe askush nuk mund të paguante për t'ju çuar më shpejt në videon e tij... sa është interneti në përgjithësi një mënyrë që njerëzit të bëhen të vetëdijshëm kur është krijuar që njerëzit të bëhen më pak të vetëdijshëm?? ...nëse ka softuer ose diçka që i bën të rinjtë më aktivë - nuk mendoj për rrjetet sociale, dua të them ndonjë softuer që, për shembull, do të sigurojë veçanërisht që zëri i tyre (rinor) të dëgjohet në Mal të Zi - atëherë unë mendoj se interneti është shumë pozitiv.

M: I3?

I3: Unë e ndaj këtë mendim me I1, sepse mendoj se rrjetet sociale janë më të dhunshme tani - ju keni shumë nga këto informacione

të rreme... Për shembull, prindërit e mi, nëna ime - kur sheh diçka në Facebook, ajo mendon se është 100 % e vërtetë dhe ju nuk mund ta bindni atë se nuk është...

M: I4?

I4: Unë dua të them se unë jam pak më i vjetër se të tjerët, prandaj dëgjova me kujdes përvojat tuaja dhe jam vërtet në rregull që të keni mendime të ndryshme, por gjithashtu do të doja të na kujtoj se gjendemi në shekullin 21 dhe duhet të vazhdojmë... Të rinjtë duhet në mënyrën e duhur të përdorin rrjetet sociale... na mbetet ne të mendojmë se si do t'i përdorim dhe në çfarë mënyre, por jo të jemi plotësisht pasivë dhe të mos i përdorim ato. Sot nëse nuk jeni në rrjetet sociale thjesht nuk ekzistoni...

I5: ...Do të doja të shikoja prapa në atë që folëm më parë - në internet dhe në mënyrën e përsosur për të marrë pjesë. Mendoj se është e nevojshme të përdoret interneti, i cili ka anët e tij të këqija, por gjithashtu ka avantazhe. Atë që ai (i anketuari i mëparshëm) përmendi për atë që ndodhi diku në Perëndim, dhe ne e dimë se Pranvera Arabe filloi në rrjetet sociale. Epo, atëherë ajo që po ndodh në vendin tonë (Malin e Zi), dhe në Serbi ajo e njëjta (protesta) ka filluar përmes mediave sociale, edhe pse kemi parë disa skena të pakëndshme (dhunë në protesta), por ne ende shohim se ajo është një mënyrë e të shprehurit të opinionëve. Këta janë shembuj ekstremë, por kështu njerëzit shprehin pikëpamjet e tyre dhe lançojnë disa iniciativa.

Çështja e internetit do të jetë përsëri aktuale kur të analizojmë se si kriza COVID-19 ndikoi në pjesëmarrjen e të rinjve. Por çështja e mekanizmave, veçanërisht në lidhje me diskutimet zyrtare dhe joformale që u zhvilluan në FG, na sjell në pyetjen e rëndësishme të institucioneve dhe sesi të anketuarit e përfshijnë hapshmërinë e tyre. Kjo tendencë e pjesëmarrësve në FG drejt një mekanizmi informal të pjesëmarrjes mund të burojë nga fakti që institucionet, të cilat duhet të jenë "mikpritësit" e mënyrave formale të pjesëmarrjes, e nuk janë një mikpritës aq i mirë. Nga shumë shembuj në këtë dhe kapitullin e mëparshëm, ne kemi parë që anëtarësimi në parti politike është nganjëherë mënyra e vetme për t'u kyçur. Por ka edhe çështje të tjera në institucionet të cilat i kanë shprehur pjesëmarrësit e FG'së, të cilat janë ende mjaft të lidhura me partitë politike që ndonjëherë janë kanali i vetëm për lëvizjen horizontale: Kjo më kujtoi në debatin publik që organizuam. Komuna lokale mori fonde nga Banka Botërore për ndërtimin e një fushe sportive, një vendi shumëfunksional për hendboll, volejboll, etj.. Kështu që, ata i morën ato investime, angazhuan ekspertë, bënë një plan ndërtimi, ndërtuan një stadium - por ata harruan të bënin vende për spektatorët. Pra, në këtë dëgjese publike, trajneri i ekipit të volejbollit u tha atyre: "Gjithçka është në rregull, por na duhen gjëra të tjera. Për shembull ku janë vendet? Pse nuk i vendosni dy rreshta vendesh sepse kemi vajza që kanë familje dhe mysafirë të tjerë që duan të ulen ndërsa shikojnë ndeshjen". E pastaj njerëzit nga komuna u përgjigjën: "Epo, si nuk na ka shkuar ndërmend të takohemi me Ju më parë?" J'u thash... duhet të inkuadrojnë njerëz që përdorin stadiumin sepse nuk ka nevojë të takohen me mua sepse unë kurrë nuk kam luajtur sporte në jetën time. Ata duhet të flasim me ekipin e basketbollit, ekipin e volejbollit... Kështu që ai takim zgjati dy minuta... Ajo është humbje e madhe. Dy rreshta karrigesh, të cilat ata tani thonë se nuk mund t'i shtojnë, sepse ndërtimi ka mbaruar, epo...

Shkollat dhe universitetet ofrojnë mundësi për të rinjtë që të inkuadrohen, dhe kjo vihet re veçanërisht nga pjesëmarrësit e FG'së nga Kosova dhe Mali i Zi. Sidomos kur ndjekin universitetet, të rinjtë janë më aktivë dhe të angazhuar gjatë studimeve të tyre (nëpërmjet Këshillit të Studentëve etj) për çështje që ndikojnë drejtpërdrejt në to, por rrallë herë për ato që nuk kanë të bëjnë me çështjet e tyre studentore.

Kur të rinjtë kyçen në aktivizëm, veçanërisht nëse janë mbështetur ose ftuar nga bashkëmoshatarët, zakonisht ka ndonjë organizatë rinore, një organizatë tjetër të shoqërisë civile (OSHC) ose një grup joformal përmes të cilit një i ri mund të vazhdojë të jetë aktiv dhe ku ai/ajo mund të marrë mundësi të tjera për t'u përfshirë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse OSHC'ja mund të ofrojë mbështetje të vazhdueshme aktivistëve të rinj, si dhe qasje më të lehtë në proceset formale të pjesëmarrjeve dhe institucioneve në të cilat këto procese formale zhvillohen. Megjithatë, meqë komunikimi me institucionet burokratike, si donatorët ndërkombëtarë dhe autoritetet komunale ose kombëtare, bëhet mbizotërues dhe i përbashkët, OSHC'ja (rinia) ndërmerr një zhargon specifik që ndonjëherë i refuzon aktivistët e rinj: Unë besoj se gjuha e përdorur në komunikimin me të rinjtë është shumë e rëndësishme, sepse ... mbase jo çdo i ri në Serbi, por 90% e të rinjve në Serbi në të vërtetë duan të bëjnë disa ndryshime. Është shumë e rëndësishme se si e përcaktojmë atë (një mjet që ata mund të përdorin). Nëse e përcaktojmë atë në ndonjë gjuhë "projektuese", duke përdorur disa terma nga organizata joqeveritare që nuk janë të qarta për njerëzit që jashtë asaj bote, mendoj se nuk ka gjasa që ne të presim të përmblisim interesin e dikujt dhe dikush të na dëgjojë.

Institucionet kanë një problem të ngjashëm, por mbase për një arsye tjetër. Ndonjëherë ata nuk janë transparentë, ata gjithashtu priren të përdorin gjuhën që shumica e njerëzve (duke përfshirë të rinjtë) nuk e kuptojnë plotësisht apo përdorin kanale ekskluzive komunikimi, të tilla si faqet e internetit që nuk janë aq popullore dhe nuk janë aq të vizituara:

I1: Komuna ka publikuar të gjitha dokumentet dhe gjithçka që kërkohet në faqe interneti. Por njerëzit nuk i përdorin ato faqe interneti. Kur njerëzit duan përgjigje nga komuna, ata nuk shkojnë në faqet e internetit për t'i gjetur ato, por hyjnë në Facebook dhe u shkruajnë atyre ose shkojnë direkt në komunën... Njerëzit mendojnë se nuk ka transparencë sepse nuk janë të informuar, sepse nuk dinë kujt t'i drejtohen për informacion. Është e vetëkuptueshme që për t'u informuar, qytetarët duhet të jenë të dedikuar. Por që të informoheni në Kosovë dhe Metohi\*, duhet të jeni shumë të angazhuar. Për shembull, për të gjetur një dokument në një faqe interneti... raportet e kostove, për shembull: departamenti i financave shpall një raport, zyra e kryetarit të komunës të dytin dhe asambleja lokale të tretin.

M: Kjo do të thotë që kjo mënyrë komunikimi nuk është shumë e përshtatshme për përdoruesit?

I1: Jo, nuk është i përshtatshëm për përdoruesit sepse është i paqartë. E pastaj, nëse jeni të detyruar të telefononi dikë përsëri që njihni në Komunë dhe t'a pyesni për diçka që ju intereson, atëherë ju shmangni atë mënyrë "evropiane" dhe ktheheni sërish në mënyrën se si zgjidhen gjërat zakonisht në Ballkan. Nuk mendoj se ato janë transparente, sepse përsëri, kur nuk kanë bashkëpunim me qytetarët, nuk ka vend për transparencë. Ju nuk mund të thoni se ka transparencë dhe debat publik kur vetëm 20 persona do të paraqiten në debat.



## COVID-19 KRIZA DHE PJESEMARRJA E TË RINJVE

Është theksuar taminë në kapitujt hyrës se pritja që të anketuarit të analizojnë dhe parashikojnë ndonjë zhvillim të mëtejshëm dhe lidhjet midis COVID-19 dhe pjesëmarrjes së të rinjve, duke pasur parasysh se pandemia është ende në vazhdim, padrejtësisht dhe jorealitsh. Sidoqoftë, ka gjetje të caktuara që mund të na ndihmojnë të kuptojmë disa nga reagimet fillestare dhe gjetjet e pjesëmarrësve në FG që mund të na çojnë në korrelacione të mundshme midis këtyre dy fenomeneve.

Kur bëhet fjalë vlerësimin sesi autoritetet e ndryshme kombëtare dhe lokale reagues ndaj pandemisë, situata në grup është e ndryshme. Megjithatë shumica e të anketuarve pajtohen se masat fillestare të rrepta ishin të pashmangshme, *pasi gjithçka ishte e re dhe askush nuk e dinte me çfarë kemi të bënim*, duket se të rinjtë në FG nga Serbia janë të pakënaqur me faktin që autoritetet kombëtare nuk e morën virusin mjaft seriozisht në fillim pastaj ajo papritmas lëvizti në masa shumë të rrepta. Kjo krijoi një ndjenjë mosbesimi dhe pasigurie shtesë: *Padyshim që nuk më pëlqente fakti që në fillim ishte një shaka jo vetëm për njerëzit përreth meje ... por edhe për autoritetet tona, ishte qesharake. "Ne i kemi mbijetuar sanksionet dhe mund t'a mbijetojmë koronën". Ishte hap i fillestar i gabuar, sepse njerëzit e dëgjuan atë kohë dhe menduan se nuk ishte asgjë e tmerrshme dhe nuk u interesonte aspak. Unë mund ta kuptoj atë në një farë mase.*

Ashtu si kuptimi i përbashkët midis pothuajse të gjithë pjesëmarrësve në FG se masat e rrepta ishin të pashmangshme në fillim të pandemisë, pavarësisht nëse u pëlqente atyre apo jo, e përbashkëta e të gjithëve është se ata nuk shohin që këto masa të rrepta zbatohen nga qytetarët (sidomos pasi njerëzit u çlodhën pak), dhe as nuk u zbatuan dhe menaxhuan në mënyrë rigorozë nga administratat lokale dhe kombëtare: *Ishte shumë mirë në fillim, por mund të themi se ishte një katastrofë nga mesi i Majit... kur hyj në ndërtesën e komunës, sepse për shembull, në komunën e Ferizajt nuk ka dezinfektues... ndonjëherë kur largohem, ata nuk kanë maska, sigurimi i lejon njerëzit të sosin punë dhe të marrin dokumente ose çfarëdo që taminë duhet të bëjnë. Është edhe më keq që zyrtarët që punojnë në institucionet publike duhet t'u japin një shembull qytetarëve, por përkundrazi...*

